

# TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

## VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË KORÇË 2024

PËRGATITUR NGA:  
GRUAJA NË ZHVILLIM KORÇË  
RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;</li> <li>• Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;</li> <li>• Qendra Rinore Vlorë,</li> <li>• Epoka e Re, Fier;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;</li> <li>• Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;</li> <li>• Qendra Rinore për Progres, Kukës,</li> <li>• Gruaja në Zhvillim Korçë;</li> <li>• Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;</li> <li>• Tjetër Vizion, Elbasan.</li> </ul>
--	---

*Ky Raport është përgatitur nga Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” në kuadër të projektit POP 2024 " Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.*

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>LISTA E SHKURTIMEVE .....</b>	<b>4</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>5</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT .....</b>	<b>6</b>
<b>METODOLOGJIA E STUDIMIT.....</b>	<b>8</b>
<b>KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR .....</b>	<b>11</b>
<b>PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË KORÇË .....</b>	<b>12</b>
<b>HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË KORÇË .....</b>	<b>18</b>
<b>VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK.....</b>	<b>22</b>
<b>PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT DHE QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIK .....</b>	<b>41</b>
<b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>50</b>
<b>REFERENCA .....</b>	<b>53</b>
<b>SHTOJCA.....</b>	<b>53</b>

## LISTA E SHKURTIMEVE

QV	Qeverisje Vendore
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
KB	Këshilli Bashkiak
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OPIC	Olof Palme International Centre
NED	National Endowment for Democracy
POP	Përballja e Ofertave Politike
GZHK	Gruaja në Zhvillim Korçë

## HYRJE

Ky raport është pjesë e studimit “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik”, të realizuar nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” (POP)<sup>1</sup> në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike”, i financuar nga “National Endowment for Democracy” dhe “Olof Palme International Center”.

Për Bashkinë Korçë, studimi është realizuar nga Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë”, anëtare e Rrjetit POP.

Studimi në nivel kombëtar synon të analizojë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në 10 Bashki të vendit, duke identifikuar praktikrat ekzistuese, nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe sfidat që lidhen me këto procese.

Përmes monitorimit të zbatimit të ligjit, intervistave me përfaqësuesit vendorë, me grupet e interesit, organizatat jo-qeveritare dhe pyetësorit *online* të plotësuar nga qytetarët, ky raport ofron një analizë të detajuar dhe rekomandime për të përmirësuar transparencën dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen vendore në Korçë. Rekomandimet adresojnë përmirësimet e nevojshme për të përmbushur standardet e mirëqeverisjes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, duke sugjeruar masat korrigjuese për të forcuar praktikrat e mira në qeverisjen vendore. Analiza është bazuar në koncepte të qeverisjes vendore dhe Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik<sup>2</sup>, duke ndihmuar në vlerësimin dhe propozimin e rekomandimeve për përmirësim.

Raporti kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit të përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe qytetarëve, si dhe në rritjen e përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse në Korçë, duke promovuar një zbatim më efektiv të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Rrjeti POP do të bashkëpunojë në një fazë të mëvonshme edhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit ku përmendim, institucionin e Prefektit, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

---

<sup>1</sup> Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/>

<sup>2</sup> Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik:  
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Shoqata "Gruaja në Zhvillim Korçë," organizatë anëtare e Rrjetit POP- "Përballja e Ofertave Politike" në kuadër të projektit "Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike," financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP, përmes këtij programi, synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Studimi është realizuar me qëllim që organizatat lokale dhe qytetarët të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë vendore për identifikimin e prioriteteve të zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi "Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Korçë" vlerësoi situatën e realizimit të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën shtator 2023 – qershor 2024, përmes monitorimit të dëgjësive publike, duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore (NjVQV).

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesore të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NJVQV-të ushtrojnë në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik<sup>3</sup>, duke vënë në dispozicion të qytetarëve hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Korçë duhet të demonstrojnë përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave të tyre me efikasitet, efektivitet dhe transparencë, në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Ndërkohë, komuniteti dhe veçanërisht shoqëria civile, nga ana e tyre, duhet të përfitojnë dhe përdorin me mençuri këto mekanizma, duke ushtruar rolin e tyre të domosdoshëm dhe fuqinë që ligji u jep në sigurimin e një qeverisjeje të drejtë, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit. Mobilizimi dhe angazhimi aktiv i qytetarëve në nivel vendor, debati i hapur, ndarja dhe shkëmbimi i përvojave dhe ideve të ndryshme, si dhe shqyrtimi i të gjitha alternativave të mundshme, duhet të jenë reale dhe jo sa për procedurë dhe fasadë, dhe duhet të realizohen në të gjitha fazat që ligji parashikon, duke mundësuar

<sup>3</sup> Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik:  
<https://qzbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

një vendimmarrje të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse. Njohja dhe zbatimi efektiv i ligjit synon të sigurojë transparencën e munguar prej vitesh ndaj vendimmarrjes së Këshillave Bashkiakë dhe të Bashkisë, të cilët zakonisht i konsiderojnë dëgjesat publike dhe konsultimet me publikun si procese që duhen bërë sa për të qenë në rregull me ligjin, dhe në shumicën e rasteve i anashkalojnë të gjitha fazat e dispozitave normative, duke lënë mënjanë dhe përjashtuar qytetarët dhe palët të tjera të interesuara (OSHC-të), duke zvogëluar ndjeshëm hapësirat e pjesëmarrjes dhe për pasojë vendimet që zbatohen bëhen më të vështira për t'u pranuar nga të gjithë aktorët e komunitetit.

Gjetjet e studimit tregojnë se qytetarët nuk kanë besim të bëhen pjesë e proceseve konsultuese dhe, në ato raste kur raportojnë që kanë qenë pjesë e tyre, ata pohojnë se zëri i tyre nuk dëgjohej, ose shumë rekomandime nuk gjejnë zbatim. Midis krahasimit të kuadrit ligjor, formave të zbatuara dhe vlerësimeve të marra në kuadër të studimit të realizuar, vëmë re se ligji zbatohet në mënyrë modeste si nga stafi i Bashkisë ashtu dhe nga legjislativi i KB.

Transparenca, konsultimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen lokale vazhdojnë të jenë sfida për autoritetet vendore, duke shërbyer në të njëjtën kohë edhe si tregues të funksionimit të demokracisë lokale. Zbatimi i Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, duke përcaktuar qartë se cilat projektakte i nënshtrohen detyrimisht konsultimit publik në nivel vendor, duhet të qartësojë nevojën për ndryshime ligjore dhe praktika shtrënguese për moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Gjithashtu, grupet e interesit, OSHC-të lokale dhe qytetarët aktivë në komunitet duhet të rrisin kapacitetet duke njohur të drejtat e tyre, për të ushtruar presion pozitiv dhe për t'u ankuar pranë institucioneve përgjegjëse dhe duke u përballur edhe në gjykatë për çështje me interes të lartë publik.

## **Gjetje kryesore**

Nga analizimi i procesit të konsultimit publik dhe transparencës në Bashkinë Korçë, janë identifikuar disa gjetje dhe mundësi për përmirësim:

- Aktualisht, nuk ekziston një pozicion i dedikuar ekskluzivisht për koordinimin e procesit të konsultimit publik, çka ndikon negativisht në menaxhimin e tij dhe në përputhshmërinë me kërkesat ligjore.
- Bashkia Korçë ka krijuar një Rregjistër Elektronik të Projektakteve për Konsultim Publik, i cili centralizon dhe strukturon projektaktet dhe dokumentet në proces konsultimi. Ky sistem ofron akses për qytetarët për të ndjekur dhe kontribuar në proceset e konsultimit.
- Aktualisht nuk është e mjaftueshme transparenca në publikimin e planeve vjetore të vendimmarrjes, të cilat nuk janë të aksesueshme për qytetarët siç kërkohet nga ligji nr. 119/2014. Kjo bën që qytetarët të mos kenë qasje të plotë në informacionet e nevojshme për përfshirje në proceset vendimmarrëse.

- Edhe pse Bashkia Korçë ka një formë të standardizuar për njoftimet publike, ajo nuk përdoret gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme. Njoftimet shpesh bëhen në kategorinë "Njoftime" dhe rrallë në Programin e Transparencës, duke munguar elemente të rëndësishme si data e publikimit dhe adresa e email-it për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve.
- Nuk ka një regjistër të qartë dhe të përditësuar për pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultimet publike, dhe format aktuale të komunikimit nuk janë të mjaftueshme për të inkurajuar pjesëmarrje të gjerë.
- Programi i Transparencës në Bashkinë Korçë nuk është në përputhje të plotë me detyrimet dhe kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 119/2014 dhe shkresën nr. 3570 (mars 2024) të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo sjell pasiguri ligjore, ul besimin e publikut në institucionet lokale dhe mund të kufizojë aksesin e qytetarëve në informacionin publik.
- Projektvendimet nuk shoqërohen gjithmonë me përmbledhje të rekomandimeve të pranuar dhe arsye për rekomandimet që nuk janë pranuar, duke kufizuar transparencën dhe besueshmërinë e procesit të konsultimit publik.
- Bashkia Korçë publikon gjithmonë njoftimet për konsultimet publike, realizon njoftimet nëpërmjet disa kanaleve, por ka nevojë për zhvillimin e kanaleve dhe metodave të reja të komunikimit për të rritur përfshirjen e qytetarëve dhe për ti bërë proceset e Konsultimit Publik më transparente dhe të ndikueshme.
- Njohuritë mbi Ligjin për Konsultimin Publik janë të kufizuara, sidomos në mesin e të rinjve dhe qytetarëve të tjerë. Megjithatë, Bashkia ka publikuar një video informuese dhe ka organizuar një sesion informues në qershor 2024 me qytetarë për të inkurajuar pjesëmarrjen e komunitetit në proceset vendimmarrëse duke theksuar rëndësinë e zërit të qytetarëve për ndryshime të rëndësishme.. Kjo tregon se Bashkia po eksploron mundësi dhe forma të reja për të përmirësuar metodat e komunikimit me qëllim rritjen e angazhimit qytetar në takimet konsultuese dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse.
- Nuk ka metoda të zhvilluara për të matur nivelin e kënaqësisë dhe besimit të qytetarëve në Proceset e Konsultimit Publik.
- Nuk ekziston një sistem i brendshëm monitorimi dhe vlerësimi për proceset e njoftimit dhe konsultimit publik, çka pengon përkrahimin e plotë dhe të qartë të gjendjes aktuale të këtyre proceseve në Bashkinë Korçë.

## METODOLOGJIA E STUDIMIT

Në kryerjen e këtij studimi, për vlerësimin në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (Ligji nr. 146/2014) në Bashkinë e Korçës, është përdorur një metodologji kërkimore gjithëpërfshirëse, duke përfshirë qasje sasiore dhe cilësore. Korniza metodologjike është artikuluar si një kombinim i (a) mbledhjes së të dhënave parësore përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me palët e interesuara në bashkinë Korçë dhe (b) marrjes së të dhënave dytësore nga dokumentet përkatëse, të cilat pasi u analizuan, çuan



në hartimin e raportit.

Në periudhën maj – qershor 2024, janë intervistuar 8 (6F/2M) zyrtarë vendorë, përfaqësues të Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak, 30 (16F/14M) përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues nga grupet e interesit që kanë qenë pjesë e dëgjësive publike në periudhën shtator 2023 - qershor 2024. Gjithashtu, një pyetësor i shpërndarë online është plotësuar nga 104 (79F/25M) banorë të Korçës që kanë dhënë vlerësimin e tyre mbi njohjen dhe perceptimin e tyre mbi njoftimin dhe konsultimin publik.

### Mbledhja e të dhënave parësore

Metoda kryesore përfshin angazhimin e drejtpërdrejtë me Institucionin e Bashkisë Korçë, përfaqësues të këtij institucioni, anëtarë të Këshillit Bashkiak Korçë, përfaqësues nga OSHK, grupe interesi dhe qytetarë:

- **Kërkesa zyrtare për informacion** drejtuar Kryetarit të Bashkisë Korçë, z. Sotiraq Filo, dhe dërguar njëkohësisht edhe Koordinatorës për të Drejtën e Informimit.<sup>4</sup>
- **Plotësimi i 4 pyetësorëve të studimit:** pyetësor për stafin e Bashkisë<sup>5</sup>, pyetësor për anëtarët e Këshillit Bashkiak,<sup>6</sup> pyetësor për grupet e interesit<sup>7</sup> dhe pyetësor për qytetarët.<sup>8</sup>

Pyetësori me qytetarët u realizua *online*, ndërsa për tre pyetësorët e tjerë, 3 persona nga GZHK zhvilluan intervista.

Pyetësorët përmbajnë pyetje cilësore dhe sasiore, duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorëve, ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat dhe informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

### Mbledhja e të dhënave dytësore

Metoda dytësore përfshin shfrytëzimin e burimeve ekzistuese, duke përfshirë dokumenta si më poshtë:

---

<sup>4</sup> Shtojca 1\_Kërkesë për informim nr.1

Shtojca 2\_Kërkesë për informim nr.2

<sup>5</sup> Shtojca 4\_Pyetësor për stafin e Bashkisë

<sup>6</sup> Shtojca 5\_Pyetësor për anëtarët e Këshillit Bashkiak

<sup>7</sup> Shtojca 6\_Pyetësor për grupet e interesit

<sup>8</sup> Shtojca 7\_Pyetësor për qytetarët

- **Analiza e raporteve dhe dokumenteve ekzistuese:** U analizuan gjetjet e raportit studimor "Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga Pushteti Vendor - Bashkia Korçë", realizuar nga GZHK si anëtare e Rrjetit POP në vitin 2022.<sup>9</sup> Gjithashtu, u rishikuan dokumente të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimet në programin e transparencës dhe raporte të prodhuara nga institucione vendore dhe ndërkombëtare.
- **Hulumtimi i mekanizmave të kontrollit:** U hulumtuan dokumentet e prodhuara nga institucionet që monitorojnë zbatimin e ligjit, përfshirë Prefekturën, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).
- **Shfrytëzimi i burimeve të internetit:** Si burim kryesor informacioni janë përdorur faqet zyrtare të internetit të Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, rregulloret e brendshme dhe publikimet e njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara.

## Hartimi i raportit

Në hartimin e raportit, të dhënat e mbledhura janë përdorur në mënyrë të strukturuar dhe analitike për të siguruar një pasqyrë të plotë dhe të saktë të situatës.

- **Integrimi i të dhënave:**

Kombinimi i të dhënave parësore dhe dytësore: Të dhënat e mbledhura nga burimet parësore dhe dytësore u kombinuan për të krijuar një pamje të plotë dhe të integruar të situatës. Kjo na lejoi të bëjmë krahasime dhe të verifikojmë informacionin, duke siguruar një analizë më të thelluar dhe të besueshme.

Përcaktimi i gjetjeve kryesore: Duke përdorur të dhënat e mbledhura, identifikuam gjetjet kryesore që tregojnë nivelin e zbatimit të ligjit, efektivitetin e mekanizmave ekzistues të njoftimit dhe konsultimit publik, si dhe sfidat dhe mundësitë për përmirësim.

- **Hartimi i rekomandimeve:**

Bazuar në analizën e të dhënave: Rekomandimet për përmirësimin e zbatimit të ligjit u bazuan në analizën e të dhënave dhe në identifikimin e praktikave të mira dhe të dobëta. Rekomandimet synojnë të adresojnë sfidat e identifikuara dhe të propozojnë masa konkrete që autoritetet vendore mund të ndërmarrin për të rritur përfshirjen dhe efektivitetin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik.

Duke ndjekur këto hapa dhe duke përdorur një qasje analitike, raporti ofron një vlerësim të plotë dhe të zbatimit të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë e Korçës dhe ofron rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi.

---

<sup>9</sup> RAPORTI STUDIMOR "INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK" – BASHKIA KORÇË  
<https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-korce/>

Në nivel kombëtar, Rrjeti POP do të konkludojë një raport të përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Vau i Dejës, Korçë, Pukë, Kukës dhe Shkodër. Ky raport do të hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme, duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësorë si burime primare dhe sekondare për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale përmes masave që autoritetet vendore duhet të ndërmarrin në lidhje me zbatimin e ligjit, si dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

## KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR

Misioni i NJVQV-e është të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve dhe të nxisë një pjesëmarrje efektive të banorëve në qeverisjen vendore. Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja publike janë parimet themelore për ruajtjen dhe avancimin e demokracisë.

Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe përfshirja e tyre në qeverisjen lokale, janë thelbësore për avancimin e demokracisë lokale, sepse forcohet legjitimiteti dhe efektiviteti i veprimeve të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak. Procesi i konsultimit publik përbën një shtyllë kryesore për një qeverisjeje transparente, duke i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogun, monitorimin dhe vlerësimin e punës së pushtetit vendor.

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në bashkinë Korçë i Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” që detyrojnë organet e vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Legjislacioni aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e Bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendimmarrje që ato kryejnë. Ndër ligjit kryesore që sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendimmarrjen lokale, më të rëndësishmit janë:

- Ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”
- Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

Duke iu referuar Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, Bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues kanë detyrimin të sigurojnë

transparencën e veprimtarive<sup>10</sup> të tyre në procesin e vendimmarrjes. Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

## PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË KORÇË

### Informacion i përgjithshëm

Që prej Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2015, Bashkia Korçë përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Korçë Qendër, Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Korçës dhe Qarkut Korçë. Bashkia ka nën administrimin e saj 1 qytet dhe 62 fshatra. Sipërfaqja e Bashkisë Korçë është 805.99 km<sup>2</sup> dhe popullsia kap shifrën 130,390 banorë. Njësitë administrative financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga buxheti i shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

### **Kryetari i Bashkisë**

*Kryetari i Bashkisë* është figura ekzekutive kryesore e qeverisjes lokale në Bashkinë Korçë. Në zbatim të Ligjit 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 44, Kryetari i Bashkisë:

- ✓ Nëpërmjet urdhërave dhe vendimeve, organizon dhe drejton punën e administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë.
- ✓ Zbaton aktet e Këshillit Bashkiak
- ✓ Etj.<sup>11</sup>

### **Nën/Kryetarët e Bashkisë**

Bashkia ka tre nënkryetarë, dy gra dhe një burrë (2F/1M).

**Administrata bashkiake** është struktura ekzekutive e bashkisë, e cila funksionon nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë, përfshin departamente dhe njësi të ndryshme dhe numri i

<sup>10</sup> Neni 16 dhe neni 18, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/12/17/139>

<sup>11</sup> RREGULLORE E DETAJUAR PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E ADMINISTRATËS SË BASHKISË KORÇË: <https://drive.google.com/file/d/119G8KAyW5seibZ4RuR9DH3N4DQ9SlxXH/view>

pozicioneve është si në vijim: 22 pozicione funksionarë politikë; 184 pozicione nëpunës civilë; 172 pozicione punonjës administrativë: 15 specialistë të fushave të ndryshme.<sup>12</sup>

**Këshilli Bashkiak Korçë** si organi legjislativ i qeverisjes lokale për mandatin katërvjeçar 2023-2027 përbëhet nga 41 anëtarë (23 M/18 F)<sup>13</sup>, 1 kryetare, 1 zëvendeskryetare dhe 1 sekretare. Anëtarët e KB kanë ngritur 15 komisione<sup>14</sup> të përbërë nga 5 anëtarë secili.

## **Dokumentet që influencojnë mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare dhe transparencës**

Komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve publike dhe qytetarëve është një ndër elementët kryesorë për të krijuar një marrëdhënie të mirë mes institucionit dhe publikut. Bashkia Korçë dhe Këshilli Bashkiak Korçë përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të komunikuar me qytetarët, duke përfshirë vendimet, njoftimet publike, takimet e hapura, konsultimet publike dhe platformat digjitale. Rregulloret dhe dokumentet e tjera rregullatore shërbejnë për të strukturuar dhe rregulluar këto procese, duke krijuar një mjedis për transparencë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

### ***Këshilli Bashkiak Korçë***

#### *Rregulloret e Këshilli Bashkiak Korçë*

Këshilli Bashkiak Korçë ka pesë rregullore kryesore.<sup>15</sup> Këto rregullore kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse dhe në mënyrën se si qytetarët mundet të ndërveprojnë me institucionet publike. Ato sigurojnë një kuadër të qartë dhe të strukturuar për pjesëmarrjen qytetare, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien. Për shembull, Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Korçë është një dokument kyç që krijon premisa për të ndikuar pozitivisht në mënyrën e funksionimit të këshillit, për të siguruar një qeverisje më efektive, transparente dhe të përfshirë qytetarisht; Kodi i sjelljes dhe parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak ndihmon në mbajtjen e integritetit të procesit vendimmarrës, ndërsa rregulloret për marrëdhëniet me publikun dhe median, si dhe për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave dhe peticioneve, parashtrajnë mekanizma dhe mundësojnë që zëri i qytetarëve të dëgjohet dhe të merret parasysh. Këto dokumente kontribuojnë në krijimin e një mjedisi ku qytetarët kanë mundësi të informohen dhe të përfshihen në qeverisjen lokale, duke përmirësuar në këtë mënyrë efektivitetin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve publike.

<sup>12</sup> Urdhër për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2024:

[https://drive.google.com/file/d/1ZluLj\\_ZEvLFtdEnaihDCZ3aR9LbrC35M/view](https://drive.google.com/file/d/1ZluLj_ZEvLFtdEnaihDCZ3aR9LbrC35M/view)

<sup>13</sup> Lista e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Korçë 2023-2027:

[https://drive.google.com/file/d/1wGsn0opkfa4\\_iZsbiDjpaSSczCgxN47k/view](https://drive.google.com/file/d/1wGsn0opkfa4_iZsbiDjpaSSczCgxN47k/view)

<sup>14</sup> Vendim për ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak Korçë:

<https://drive.google.com/file/d/1uodTMFPEBSiihjN4tb0M4rxkEMV0C3wu/view>

<sup>15</sup> Rregullore të Këshillit Bashkiak Korçë:

<https://bashkiakorces.gov.al/site/articles.php?cid=316&t=Rregulloret-e-K%C3%ABshillit-Bashkiak>

### Rregulloria për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Korçë<sup>16</sup>

Duke shqyrtuar këtë rregullore të miratuar me vendim KB NR.80, datë 30.07.2020) vëmë re se KB ka disa të drejta dhe detyrime për të organizuar njoftimin dhe konsultimin publik dhe për të drejtën e informimit:

- *Neni 136* - Informimi dhe Konsultimi Publik i Projekt-Buxhetit: Është parashikuar mënyra e dokumentimit dhe reflektimi i propozimeve për ndryshime në Projekt-Buxhet, pas konsultimeve publike dhe publikimi i tyre.
- *Neni 137* - Dokumentimi dhe reflektimi i propozimeve për ndryshime në Projekt-Buxhet, pas konsultimeve publike dhe publikimi i tyre.
- *Neni 151* - Të drejtat e qytetarëve për pjesëmarrje në qeverisjen bashkiake.
- *Neni 152* - Konsultimi i publikut me projektaktet e depozituara në Këshill për shqyrtim.
- *Neni 154* - Administrimi i kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve.
- *Shtojca nr. 15* - Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Këshillit: Përcaktohen detyrat e tij në lidhje me marrëdhëniet me komunitetin, në respektim të:
  - Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në lidhje me kërkesat e qytetarëve/OJF/person fizik dhe juridik për dokumente dhe informacionet për vendimet e Këshillit.
  - Iniciativat dhe nismat qytetare (duke përfshirë petitionet) për vendimmarrjen e Këshillit, të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
  - Konsultimet publike në respektim të Ligjit 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".
- *Shtojca nr. 24* - Model peticioni dërguar Këshillit Bashkiak.

### Rregulloria për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak Korçë me publikun dhe mediat<sup>17</sup>

Kjo rregullore e miratuar me Vendim KB nr.115, në mbledhjen me datë 1.10.2020 dhe konfirmuar nga Institucioni i Prefektit, vazhdon të mbetet një dokument në arkivat *online*

që pak zbatohet nga vetë anëtarët e KB. Ajo përmban ndër të tjera edhe format e pjesëmarrjes, njoftimit dhe këshillimit të publikut, por ende pjesa më e madhe e tyre mbeten të pa realizuara.

Kreu IV i kësaj rregulloreje përfshin 25 nene specifike për njoftimin dhe këshillimin e publikut, nga 49 nenet gjithsej të rregullores.

<sup>16</sup> Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Korçë  
<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Rregullore%20Bashkia%20Kor%C3%A7%C3%AB.%20Dokument%20fin%20Dt.04.08.2020.pdf>

<sup>17</sup> Rregullore E Këshillit Bashkiak Marrëdhëniet E Këshillit Bashkiak Me Publikun Dhe Median  
<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/MARR%C3%8BDH%C3%8BNIET%20E%20K%C3%8BSHILLIT%20BASHKIAK%20ME%20PUBLIKUN%20DHE%20MEDIAN%20%282%29.pdf>

Megjithëse termi "konsultim publik" nuk përdoret shpesh, përmbajtja e 25 neneve të Kreut IV lidhet drejtpërdrejt me konceptin e konsultimit publik. Këto nene përmbajnë udhëzime të detajuara dhe detyrime specifike për Këshillin Bashkiak lidhur me përfshirjen dhe këshillimin e publikut, detajet e procesit të këshillimit publik, që në thelb përfshin konsultimin publik. Pavarësisht titullit të rregullores, përmbajtja e këtyre neneve është qartë e orientuar drejt konsultimit dhe këshillimit publik, duke përfshirë detyrimet dhe standartet që duhet të ndjekë Këshilli Bashkiak për të siguruar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

### Rregullorja për funksionimin e strukturave komunitare në bashki<sup>18</sup>

Sipas Nenit 25 të kësaj rregulloreje kryesia apo këshilli komunitar ka për detyrë të nxisë komunitetin dhe të marrë pjesë në dëgjuesat publike të organizuara nga Këshilli Bashkiak për çështje që ndikojnë fshatin apo lagjen, si dhe të mbështesë peticione për vendime që janë në interes të banorëve. Neni 82 thekson mobilizimin dhe angazhimin e komunitetit për të marrë pjesë në konsultime publike lidhur me buxhetin vjetor, paketën fiskale, prioritetet strategjike, planifikimin e territorit, shërbimet publike, projektet zhvilluese dhe investimet me ndikim në mjedis.

### Rregullore që rregullon paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare.<sup>19</sup>

Kjo rregullore ofron mekanizma për qytetarët me fokus forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën lokale. Dispozitat specifike në Nenin 39 dhe Nenin 40 sigurojnë që qytetarët të kenë mjete efektive për të adresuar moszbatimin e kërkesave për njoftim dhe konsultim publik, si dhe për të drejtat e tyre për informim. Kjo rregullore nxit pjesëmarrjen aktive të komunitetit, duke siguruar që zëri i qytetarëve të dëgjohet dhe të merret parasysh në proceset vendimmarrëse.

### Rregjistri elektronik i projektakteve për konsultim publik, të Këshillit Bashkiak<sup>20</sup>

Për këtë periudhë raportimi janë pasqyruar në regjistrin elektronik 6 projekt-akte. Të gjitha projektaktet dhe të dhënat e lidhura me konsultimin e tyre ndodhen në regjistrin elektronik, ku janë publikuar sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, germa a) të Ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

<sup>18</sup>Rregullore Për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashki

<https://bashkiakorke.gov.al/files4users/files/RREGULLORE%20PER%20NGRITJEN%2C%20FUNKSIONIMIN%20DHE%20NDERVEPRIMIN%20E%20STRUKTURAVE%20KOMUNITARE%20NE%20BASHKI.pdf>

<sup>19</sup> Rregullore e Këshillit Bashkiak Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare

<https://bashkiakorke.gov.al/files4users/files/RREGULLORE%20E%20K.B%20PARAQITJA%20DHE%20SHQYRTIMI%20I%20ANKESAVE%2C%20VEREJTJEVE%2C%20KERKESAVE%2C%20PETICIONEVE%20DHE%20INICIATIVAVE%20QYTETARE%20%281%29%20%281%29.pdf>

<sup>20</sup> Rregjistri elektronik i projektakteve për konsultim publik, të Këshillit Bashkiak Bashkia Korçë

<https://docs.google.com/spreadsheets/d/1UYq08gHYMKzLUkpFPmSmrxxgp-eEa5kX1rWOO3cgW5c/edit#gid=0>

Në këtë regjistër është vendosur vetëm një link për raportin e rezultateve të konsultimit publik për një projektakt. Për konsultimet e tjera publike mungojnë këto raporte, ndoshta sepse janë ende në proces. Projektvendimet e projektakteve janë të publikuara në faqen e internetit të Bashkisë.<sup>21</sup>

### Plani i konsultimeve të Këshillit Bashkiak Korçë

Vendimi për planin e aktiviteteve dhe konsultimeve publike për vitin 2023 dhe matrica e shpenzimeve korrente dhe investimeve me produktet përfundimtare për vitin 2023 ndodhen të postuara në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë.<sup>22</sup> Linku përkatës ndodhet i postuar edhe tek Programi i Transparencës.

Plani i aktiviteteve i Këshillit Bashkiak të Korçës dhe ai i konsultimeve publike për vitin 2024 është i publikuar në faqen e Bashkisë Korçë, bashkëngjitur VKB Nr. 156, datë 07.12.2023, "Për miratimin e planit të aktiviteteve 2024 dhe planit të konsultimeve publike 2024"<sup>23</sup>. Ky plan përmban kalendarin e aktiviteteve me bazë mujore, por nuk ishte botuar tek Programi i Transparencës.

### Projektvendimet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

Projektvendimet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak të Korçës<sup>24</sup> janë të publikuara në faqen e internetit të Bashkisë. Përveç projektvendimeve, në këtë faqe janë publikuar edhe njoftimet për mbledhjet dhe relacionet për çështjet e trajtuara.

## **Bashkia Korçë**

Bashkia Korçë ka një rregullore të detajuar për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës<sup>25</sup> së saj. Në këtë rregullore përshkruhen qartë detyrat e administratës së Bashkisë, ndërsa detyrat e administratës së njësive administrative<sup>26</sup> përshkruhen në një dokument të veçantë, të publikuar në Programin e Transparencës. Në këtë rregullore citohet se Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar, ka për detyrë të sigurojë informacion dhe të inkurajojë pjesëmarrjen qytetare. Kjo drejtori është përgjegjëse për mbështetjen dhe promovimin e angazhimit të Bashkisë për një

<sup>21</sup> Projektvendimet e projektakteve, Bashkia Korçë

<https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=419&t=Projekt-Vendime>

<sup>22</sup> Plani i konsultimeve të Këshillit Bashkiak Korçë (janar-dhjetor 2023)

<https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=393&t=Plani-Vjetor-i-pun%C3%ABs-i-K%C3%ABshillit-Bashkiak>

<sup>23</sup> VKB Nr. 156, datë 07.12.2023, "Për miratimin e planit të aktiviteteve 2024 dhe planit të konsultimeve publike 2024"

<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Vendimi-Nr.156%281%29.pdf>

<sup>24</sup> Projektvendimet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

<https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=419&t=Projekt-Vendime>

<sup>25</sup> Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës, Bashkia Korçë

<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Rregullore%20Bashkia%20Kor%C3%A7%C3%AB.%20Dokumenti%20final%20Dt.04.08.2020.pdf>

<sup>26</sup> Detyrat e administratës së NJA-ve

<https://drive.google.com/file/d/1dN8gDR-P8VPbLdEurfEP1htrwXwuC93Y/view>



qeverisje të hapur dhe transparente, duke ofruar një shërbim profesional në marrëdhëniet me publikun.

Në përpunime me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik, Bashkia është e detyruar të garantojë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Për këtë qëllim, caktohet një koordinator. Në këtë rregullore nuk ka detyra të përcaktuara për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik.

Për të marrë informacion mbi emërimin e Koordinatorit për Konsultimin Publik, dorëzuam në Bashki një kërkesë zyrtare<sup>27</sup>. Në përgjigje, na u dërgua Urdhri Nr. 157, datë 12.09.2016, për emërimin e Koordinatorit për Informimin Publik, e cila mbante edhe funksionin e Drejtoreshës së Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar. Sipas Programit të Transparencës, i njëjti person mban edhe detyrën e Koordinatorit për Konsultimin Publik. Aktualisht, Bashkia Korçë nuk ka detyra specifike për këtë koordinator dhe nuk ka një drejtor të kësaj pozicioni. Urdhërat e brendshëm për vitet 2023 dhe 2024 (Urdhri Nr. 815, datë 16.08.2023, dhe Urdhri Nr. 32, datë 17.01.2024<sup>28</sup>) konfirmojnë se Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar është zëvendësuar nga një sektor me të njëjtin emërtim, i cili ka një përgjegjës sektori. Ky ristrukturim tregon një mungesë të qartë të fokusit në konsultimin publik dhe thekson nevojën për përcaktimin e qartë të përgjegjësisë dhe detyrave për koordinatorin e konsultimit publik dhe informimin qytetar, për të siguruar një proces vendimmarrjeje të hapur dhe pjesëmarrës.

## **Programi i Transparencës**

Në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Korçë gjendet Programi i Transparencës<sup>29</sup>, i cili ka filluar në vitin 2017. Kjo platformë është e lehtë për t'u përdorur dhe e mirëstrukturuar, duke përfshirë shtatë fusha, ndër të cilat edhe Fusha VI: Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje. Në këtë program janë paraqitur shumë mirë publikimet e ligjeve, kodeve dhe konventave të ratifikuara nga vendi ynë, por mungojnë dokumente politike vendore.

Tek Fusha VI: Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje, gjenden të dhënat për Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Janë publikuar kalendarët e konsultimeve publike për vitin 2023, të cilët përmbajnë vetëm të dhëna mbi datën, objektin dhe personat përgjegjës, por nuk ka informacion për vitin 2024. Ka informacion shumë të shkurtër dhe jo të plotë mbi detyrimet për njoftimin dhe konsultimin publik, aktet e detyrueshme për kryerjen e konsultimit publik, procedurën e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve, procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim, dhe procedurat për iniciativat qytetare

<sup>27</sup> Shtojca 1\_ Kërkesë për informim nr.1

<sup>28</sup> Urdhër për miratimin e strukturës së administratës të Bashkisë Korçë për vitin 2024  
[https://drive.google.com/file/d/1ZluLj\\_ZEvLFtdEnaihDCZ3aR9LbrC35M/view](https://drive.google.com/file/d/1ZluLj_ZEvLFtdEnaihDCZ3aR9LbrC35M/view)

<sup>29</sup> Programi i Transparencës, bashkia Korçë  
<https://sites.google.com/view/bashkiakor/home>



Në këtë program mungon Raporti Vjetor për Transparencën dhe regjistri i brendshëm i peticioneve dhe iniciativave qytetare është i papërditësuar. Gjithashtu, ka shumë pak njoftime për konsultime publike.

## HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË KORÇË

Procesi i njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Korçë ka një historik, i cili pasqyron përpjekjet e vazhdueshme për të rritur transparencën dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje. Ky proces ka kaluar nëpër disa faza zhvillimi, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar evolucionin dhe përmirësimet e bëra në këtë drejtim.

### ***Faza e hershme***

Në vitet e para të pas tranzicionit demokratik, Bashkia Korçë, ashtu si shumica e bashkive në Shqipëri, kishte një proces të kufizuar të njoftimit dhe konsultimit publik. Vendimmarrjet kryesisht ishin të centralizuara dhe roli i qytetarëve në këto procese ishte minimal. Komunikimi me publikun ishte sporadik dhe nuk kishte një strukturë të mirëpërcaktuar për njoftimin dhe konsultimin me qytetarët.

Në vitin 1990, Shqipëria hyri në një periudhë tranzicioni drejt demokracisë. Në periudhën e parë, Bashkia Korçë si të gjitha institucionet e tjera filloi të krijojë mekanizma të reja për përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

- **Njoftimi publik:** Filluan të zhvillohen praktika të reja për njoftimin publik të vendimeve dhe aktiviteteve të Bashkisë përmes shpalljeve publike, afishimit të lajmërimeve.
- **Konsultimi publik:** U hodhën hapat e parë drejt përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje përmes mbledhjeve publike dhe dëgjësive me komunitetin.

### **Modernizimi dhe përdorimi i teknologjisë**

Me përhapjen e internetit dhe teknologjive të reja, Bashkia Korçë filloi të përmirësojë metodat e njoftimit dhe konsultimit publik.

- Webfaqja zyrtare: Bashkia krijoi një faqe zyrtare në internet ku publikoheshin informacione mbi vendimet, projektet dhe aktivitetet e Bashkisë.
- Mediat Sociale: Filloi përdorimi i *mediave sociale* si një mjet i ri për njoftime dhe për të ndërtuar një kanal komunikimi me qytetarët.

### **Transparenca dhe përfshirja më e gjerë**

Në dekadën e fundit, Bashkia Korçë ka rritur përpjekjet për të siguruar transparencë dhe përfshirje të gjerë të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

### **Formalizimi i procesit**

Me miratimin e Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në vitin 2014, Bashkia Korçë përmirësoi dhe formalizoi proceset e saj të njoftimit dhe konsultimit publik. Ky ligj krijoi një kornizë ligjore për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse. Përmes këtij ligji, Bashkia u detyrua të sigurojë njoftim për publikun mbi vendimet dhe politikat e propozuara dhe të organizojë konsultime publike për të mbledhur opinione dhe sugjerime.

Që prej shtatorit 2009, në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë, gjenden njoftime për konsultime me qytetarët për investimet publike, në kuadër të programit "Bashkia për Qytetarët" dhe projektit "Buxheti me Pjesëmarrje".<sup>30</sup>

### **Periudha e konsolidimit**

Pas miratimit të ligjit, Bashkia Korçë ndërmori hapa për të konsoliduar procesin e konsultimit publik. U krijuan mekanizma specifike për të garantuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara. Këto përfshinin:

- Portalet elektronike: U krijuan portale online ku qytetarët mund të informohen mbi vendimet e ardhshme dhe të japin sugjerimet e tyre. Në vitin 2017 Bashkia Korçë krijoi faqen *web* "Programi i Tansparencës".
- Pytësorë online për konsultime publike, ku qytetarët mund të japin mendimet e tyre për buxhetin afatmesëm.
- Takime publike dhe dëgjesa: Bashkia organizon takime publike dhe dëgjesa me qytetarët për të diskutuar mbi çështje të ndryshme që prekin komunitetin.
- Transmetime live: Mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe aktivitete të tjera transmetohen live në faqen Facebook të KB Korçë, duke kontribuar për një transparencë më të madhe dhe një mundësi më të gjerë për qytetarët që të jenë të informuar dhe të përfshirë.

<sup>30</sup> <https://bashkiakorçe.gov.al/site/article.php?aid=267&cid=38>

### ***Përpjekjet e fundit për përmirësim***

Në vitet e fundit, Bashkia Korçë ka intensifikuar përpjekjet për të përmirësuar më tej proceset e njoftimit dhe konsultimit publik. Këto përfshijnë:

- **Fushatat informative:** Janë ndërmarrë fushata informative për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse. Së fundmi, mund të përmendim Sesionin Informues që u zhvillua më 5 qershor 2024, me aktorë të ndryshëm pjesëmarrës, si nxënës, mësues, përfaqësues nga shoqëria civile, etj. Qëllimi i tij ishte nxitja e komunitetit për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse të këshillit.
- **Bashkëpunimi me OSHC-të:** Bashkia ka forcuar bashkëpunimin me organizatat joqeveritare për të siguruar një pjesëmarrje më të gjerë dhe të larmishme në konsultime.

Ndër vite, aktorë të ndryshëm kanë arritur të bëjnë monitorime, matje dhe vlerësime mbi nivelin e transparencës në nivel vendor. Edhe Bashkia Korçë ka qenë pjesë e këtyre monitorimeve, të cilat kanë nxjerrë në pah arritjet dhe problematikat e hasura, si dhe kanë bërë një krahasim të punës së saj me bashkitë e tjera. Nga këto raporte në lidhje me nivelin e transparencës, Bashkia Korçë rezulton si një nga bashkitë më progresive në vend. Duke iu referuar raporteve të fundit, mund të përmendim: për vitin 2023, Bashkia Korçë është renditur ndërmjet tre bashkive me performancën më të lartë (Shkodër, Korçë dhe Lezhë), të cilat kanë realizuar kërkesat e legjislacionit sa i përket transparencës në masën 100%.<sup>31</sup>

Historia e proceseve të njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Korçë reflekton një zhvillim të vazhdueshëm drejt transparencës dhe përfshirjes qytetare. Nga një periudhë e kontrolluar dhe e kufizuar gjatë regjimit komunist, deri te një mjedis më i hapur dhe i teknologjizuar sot, përpjekjet për të përmirësuar komunikimin dhe përfshirjen e publikut janë intensifikuar ndjeshëm. Pavarsisht këtij progresi, ka ende shumë hapësirë për përmirësim. Për të arritur një përfshirje më të gjerë dhe efektive të qytetarëve, është e nevojshme të zhvillohen kanale dhe metoda të reja.

***Për më tepër, duhet të sigurohet që proceset e konsultimit publik të jenë jo vetëm transparente, por edhe të ndikueshme, ku mendimet dhe sugjerimet e qytetarëve të kenë një ndikim të vërtetë në vendimmarrje.***

### **Realizimi i procesit të njoftimit dhe konsultimit publik për dy vitet e fundit**

#### ***Konsultimi publik për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026***

##### **✓ Sondazh online**

Këshilli Bashkiak i Korçës ka kryer procedurat për njoftimin dhe konsultimin publik për qytetarët dhe grupet e interesit në përputhje me Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e

<sup>31</sup> Raporti I Monitorimit Të Zbatimit Të Detyrimeve Ligjore Të Sigurimit Të Transparencës Dhe Procesit Të Konsultimit Publik Nga Bashkitë (Faktoje.AL)  
[https://faktoje.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti-i-Monitorimit\\_10-bashki-Final-2023.pdf](https://faktoje.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti-i-Monitorimit_10-bashki-Final-2023.pdf)

vetëqeverisjes vendore”. Gjatë muajit shkurt 2023, Këshilli Bashkiak i Korçës ka realizuar një sondazh *online* për përcaktimin e prioriteteve të komunitetit.<sup>32</sup> Ky sondazh ka ofruar informacion të përmbledhur mbi mënyrën se si janë shpenzuar fondet publike në bashki gjatë vitit 2022 dhe u ka dhënë mundësinë komunitetit të rekomandojë funksionet/shërbimet prioritare për të cilat Bashkia duhet të shpenzojë më shumë para gjatë vitit të ardhshëm 2024, në kuadër të përgatitjes së tavaneve buxhetore 2024-2026.

Në lidhje me programin buxhetor afatmesëm 2024-2026, janë respektuar të gjitha procedurat e mëposhtme: seanca dëgjimore, miratimi i tavaneve përgatitore, miratimi i tavaneve përfundimtare dhe miratimi i dokumentit përfundimtar të projekt-buxhetit, brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj. Gjatë muajve tetor dhe nëntor, Këshilli Bashkiak i Korçës i është bashkuar dëgjesave publike të organizuara nga Bashkia Korçë për projektbuxhetin vjetor të vitit pasardhës.

### Konsultime publike

Gjatë periudhës shkurt-qershor 2024 janë kryer konsultime publike në lidhje me katër projektakte: Rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor, Plani për arsimin parashkollor 2024-2026, miratimi i planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore Panarit-Treskë, "Përparimaj-Dardhë," Voskopojë, Voskopojë 2, Zëmlak-Qarr dhe ekonomisë kullimore "Rungajë," si dhe miratimi i vazhimit të procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullor për sipërfaqen pyjore që do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor pranë fshatit Mazrekë.

Në lidhje me programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, projektakti nuk është pasqyruar në regjistrin elektronik të konsultimeve publike të Këshillit Bashkiak Korçë.

Gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26 qershor 2024, nuk u arrit miratimi i pikës 9 të rendit të ditës “Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, faza e parë”, çka çoi në mosmiratimin e programit. Këshilltarët e opozitës kërkuan marrjen e masave për fillimin e



<sup>32</sup> Sondazh për përcaktimin e prioriteteve të komunitetit

[https://forms.office.com/Pages/ResponsePage.aspx?id=nWQNBpMs0kSCAKPrnzxBYM\\_YLURqjRxAuHbFb00J-HVUN1dERDM2QVNITUhXNTRaWfK2SUFPMVIGUj4u](https://forms.office.com/Pages/ResponsePage.aspx?id=nWQNBpMs0kSCAKPrnzxBYM_YLURqjRxAuHbFb00J-HVUN1dERDM2QVNITUhXNTRaWfK2SUFPMVIGUj4u)

Analiza e sondazhit në lidhje me prioritetet e publikut për projektbuxhetin afatmesëm 2024-2026

<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Rezultatet%20e%20sondazhit%20per%20prioritetet%20e%20komuniteti%20C%20ne%20lidhje%20me%20tavanet%20pergatitore%20buxhetore%202024-2026.pdf>

Shkresa për administratën në lidhje me Rezultatet e sondazhit për prioritetet e komunitetit, në lidhje me tavanët përgatitore buxhetore 2024-2026.pdf

<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Shkresa%20per%20administraten%20ne%20lidhje%20me%20Rezultatet%20e%20sondazhit%20per%20prioritetet%20e%20komunitetit%20C%20ne%20lidhje%20me%20tavanet%20pergatitore%20buxhetore%20C2%A02024-2026.pdf>

konsultimeve publike për dokumentin e këtij programi, të cilat duhej të kishin filluar që në fazën e parë, bazuar në kalendarin e planit të punës të Këshillit Bashkiak.

Për të garantuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe transparencën në vendimmarrje, në bashkinë Korçë janë ngritur mekanizma të ndryshëm, të tillë si:

*Seancat e hapura të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak:*

Seancat e hapura për publikun, ku qytetarët mund të marrin pjesë dhe të shprehin opinionet e tyre. Këto mbledhje transmetohen *live* në faqen *Facebook* të Këshillit Bashkiak Korçë<sup>33</sup>. Gjithashtu, aty publikohen ftesat për konsultime publike me banorët dhe grupet e interesit.

## **VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK**

Vlerësimi i efektivitetit dhe transparencës së Procesit të Konsultimit Publik në bashkitë përbën një aspekt kyç për të kuptuar se sa mirë funksionon ky mekanizëm demokratik dhe për të identifikuar hapësirat për përmirësim. Kuadri ligjor në fuqi parashikon një sërë detyrimesh dhe përgjegjësisish në lidhje me format dhe mjetet që institucionet publike duhet të vënë në dispozicion për të krijuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e informimit, njoftimit dhe përfshirjes së tyre në konsultim publik dhe vendimmarrje.

Për të parë ecurinë e këtyre proceseve në respekt edhe të detyrimeve ligjore për periudhën shtator 2023 - qershor 2024, u zhvillua ky studim në Bashkinë Korçë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm.

*Dërgimi i kërkesave zyrtare për informacion*

Si fillim për realizimin e studimit procesi filloi me dërgimin e disa kërkesave zyrtare për informacion drejtuar Kryetarit të Bashkisë Korçë, z. Sotiraq Filo dhe njëkohësisht edhe Koordinatorës për të Drejtën e Informimit. Përgjigjet e marra ishin brenda afatit ligjor.

*Intevista me stafin e Bashkisë*

Procesi vazhdoi me intervista të drejtpërdrejta me stafin e Bashkisë Korçë. Në përpjekjen tonë për të vlerësuar praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Korçë, kemi arritur të realizojmë vetëm 3 intervista nga 5 të planifikuara me staf nga Bashkia Korçë. Disponueshmëria e stafit kyç të Bashkisë ishte e limituar për shkak se funksionet e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Transparencës i përkasin një personi të vetëm, gjë që ndikoi në reduktimin e numrit të intervistave të mundshme. Gjithashtu, nuk u arrit të bëjmë intervistën e

---

<sup>33</sup> Faqja *Facebook* e Këshillit Bashkiak Korçë  
<https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce>

planifikuar me Nën/kryetaren e Bashkisë, e cila mbulon funksionet për çështjen në fjalë, për shkak të ngarkesave të saj të përditshme.

Të intervistuarit i përkisnin Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Përgjithshme të Financave, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Një prej tyre ishte përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe njëkohësisht koordinatore për të Drejtën e Informimit dhe Konsultimin Publik.

#### *Intevista me anëtarë nga Këshilli Bashkiak*

Pesë të intervistuarit nga Këshilli Bashkiak janë anëtarë të komisioneve të ndryshme, përfshirë edhe Kryetarin, Zv./Kryetarin dhe Sekretarin e Këshillit. Ata përfaqësonin: një anëtar i Komisionit të Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikëqyrjes Financiare, dy anëtarë i Komisionit të Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë.

Në përpjekjen tonë për të realizuar intervistën edhe me një anëtar të Komisionit të Peticioneve, Kërkesave dhe Ankesave, u përballëm me faktin se Këshilli Bashkiak Korçë nuk ka një komision të tillë.

Nga informacioni i marrë gjatë këtij procesi dhe analizës së tij, si dhe nga monitorimi i, dolën në pah disa gjetje si më poshtë:

### **Rëndësia e pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak dhe njohja e bazës ligjore**

Përgjigjet e të intervistuarve në lidhje me pyetjen se sa e rëndësishme është pjesëmarrja e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak kanë treguar një përkushtim të fortë ndaj transparencës dhe përfshirjes së publikut në proceset vendimmarrëse. Pavarësisht roleve të ndryshme, të gjithë janë dakord që konsultimi dhe përfshirja e qytetarëve janë komponentë kritikë për një qeverisje efektive dhe të drejtë. Disa prej tyre kanë sjellë argumente dhe shembuj konkretë që ilustrojnë rëndësinë e këtyre proceseve, si për shembull rastin kur konsultimi publik çoi në tërheqjen e një projekti për ndërtimin e TEC-it, duke treguar fuqinë e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje në Bashkinë Korçë. Kjo tregon se përfshirja e qytetarëve mund të ndikojë në vendimet e marra dhe të përmirësojë cilësinë e qeverisjes vendore. Këto përgjigje pasqyrojnë një kulturë institucionale të orientuar drejt pjesëmarrjes dhe përgjegjshmërisë, e cila është e nevojshme për zhvillimin e një demokracie të qëndrueshme dhe të hapur në nivel vendor.

Nga përgjigjet e të intervistuarve për pyetjen se sa e njohin bazën ligjore për angazhimin dhe konsultimin e publikut në vendimmarrjen vendore dhe nëse Këshilli Bashkiak i Korçës ka një rregullore për konsultimin publik, 100% kanë konfirmuar njohjen e bazës ligjore dhe rregullores përkatëse. Në lidhje me vlerësimin që anëtarët e Këshillit Bashkiak kanë bërë për kuadrin ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor, analiza e përgjigjeve tregon se shumica (60%) e të anketuarve, pra 3 persona (F), vlerësojnë se

kuadri ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik është i qartë dhe i plotë. Ndërkohë, 20% (1 person) e vlerësojnë se kuadri ligjor është i paqartë dhe jo i plotë, dhe 20% (1 person M) të tjerë e vlerësojnë se kuadri ligjor është i qartë, por jo i plotë. Nëse bëjmë një krahasim për të njëjtën çështje me studimin që rrjeti POP ka bërë dy vjet më parë, nga intervistat me anëtarët e Këshillit Bashkiak të Korçës ka rezultuar se 85.7% e tyre e përcaktojnë kuadrin ligjor të qartë dhe të plotë, ndërsa 14.3% e konsiderojnë të qartë, por jo të plotë.

Numri i vogël i intervistuesve në të dy studimet mund të ndikojë në përqindjet e raportuara, por prania e këtij perceptimi në të dyja periudhat sugjeron një shqetësim të vazhdueshëm dhe të rëndësishëm. Perceptimi që ligji nuk është i plotë mbetet i qëndrueshëm në të dy studimet, duke treguar se ka aspekte të rëndësishme që nuk janë të mbuluara në mënyrë të mjaftueshme. Pavarësisht se ligjet mund të jenë të formuluar mirë, ndryshimet në nevojat dhe realitetet sociale kërkojnë që të përditësohen dhe përmirësohen vazhdimisht për të mbuluar të gjitha aspektet e kërkuara.

Disa nga propozimet e tyre për përmirësim janë si më poshtë:

- Shfrytëzimi i teknologjisë: Në kohën që jetojmë, teknologjia duhet të shfrytëzohet për të informuar qytetarët në kohë reale dhe sa më shpejt të jetë e mundur. Metodat fleksibile dhe të shpejta duhet të integrohen si pjesë e legjislacionit dhe praktikave institucionale.
- Zbatueshmëria e ligjeve dhe pjesëmarrja e administratës: Ligjet janë të mirëformuluara, por shpesh janë të pazbatueshme praktikisht. Administrata e Bashkisë duhet të jetë e përfshirë realisht në konsultimet publike, pasi mungon transparenca sipas kuadrit ligjor.

***Gjetje: Nevoja për përmirësimin jo vetëm të kuadrit ligjor, por edhe të praktikave institucionale në Bashkinë Korçë, për të garantuar një pjesëmarrje dhe konsultim publik më efektiv dhe transparent.***

### **Standartizimi Procedurës Administrative të Njoftimit dhe Konsultimit Publik**

Në lidhje me standardizimin e Procedurës Administrative të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, dy nga tre anëtarët e stafit të bashkisë të intervistuar konfirmuan se procedura ishte e standardizuar, ndërsa njëri prej tyre nuk dha përgjigje.

Nga kërkimi ynë nuk rezultuan rregullore apo urdhëra të brendshëm në lidhje me këtë. Gjatë periudhës së monitorimit, në regjistrin elektronik të Këshillit Bashkiak<sup>34</sup> janë publikuar 5 projektakte.

<sup>34</sup> Regjistri i projekt akteve për konsultim publik, të Këshillit Bashkiak Korçë:

<https://docs.google.com/spreadsheets/d/1UYq08gHYMKzLUkpFPmSmrxxgp-eEa5kX1rW003cgW5c/edit#gid=0>



Njoftimet për konsultimet publike bëhen në kategorinë "Njoftime", në faqen e *web-it* të Bashkisë<sup>35</sup>, kategoria Njoftime<sup>36</sup> dhe shumë rallë tek Programi i Transparencës.<sup>37</sup> Tek njoftimet janë vendosur: titulli, propozuesi, sqarime për projektaktin, kalendari me datat përkatëse, linku i dokumenteve për konsultim, pjesëmarrësit nga institucioni i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, kush mund të marrë pjesë nga komuniteti, forma e konsultimit, qëllimi, përshkrimi i çështjeve që trajton konsultimi, pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut, ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme, kontakti me e-mail dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve dhe vërejtjeve, si dhe data e publikimit.

Ka raste kur njoftimet janë të shkurtra dhe nuk i përmbajnë të gjitha elementet e përshkruara më lart. Megjithatë, këto informacione pasqyrohen në kalendarët e Konsultimit Publik, të cilët janë të detajuar. Në këto kalendarë mungojnë data e publikimeve dhe adresa email ku mund të dërgohen komentet, rekomandimet dhe vërejtjet, si dhe afatet për dërgimin e tyre.

***Gjetje: Mospërdorimi i një forme të vetme të standardizuar për të gjitha njoftimet, që të përfshijë të gjitha informacionet e nevojshme për qytetarët.***

### **Mekanizmat dhe proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët**

Në lidhje me mekanizmat dhe proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimit publik, dy nga tre të intervistuarit nga stafi i Bashkisë veçuan buxhetimin me pjesëmarrje "Fjalën e ke ti" si një ndër mekanizmat më efektivë. Ato gjithashtu vlerësuan dëgjuesat me grupet e ndryshme të interesit, siç është sektori i turizmit. Drejtorja e Financës konfirmoi se këto konsultime janë të përcaktuara në kalendar për çështje si PPV (Planifikimi i Përgjithshëm Vendor), buxheti dhe paketa fiskale.

Megjithatë, mungesa e përgjigjes nga një prej të intervistuarve nënvizon nevojën për përfshirjen e të gjitha drejtorive për të siguruar bashkëpunim dhe një zbatim të plotë dhe të përshtatshëm të procedurave, në përputhje me ligjin dhe standardet administrative të përcaktuara.

Në anën tjetër, të intervistuarit nga Këshilli Bashkiak pohojnë se bashkëpunojnë me Bashkinë. Pyetjes nëse ka bashkëpunim mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, shumica (80%, pra 4 anëtarë) raportojnë se ka një bashkëpunim mes tyre për këtë proces, ndërsa vetëm një anëtar (20%) pohon mungesën e këtij bashkëpunimi. Krahasuar me rezultatet e studimit të realizuar nga POP në vitin 2022, shifrat aktualisht shfaqin një përputhje prej 86% me 14%.

<sup>35</sup> Faqja zyrtare Bashkia Korçë: [www.bashkiakorce.gov.al](http://www.bashkiakorce.gov.al)

<sup>36</sup> : <https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&t=Njoftimet>

<sup>37</sup> Programi i Transparencës: Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje <https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/njoftimi-p%C3%ABr-nism%C3%ABn-vendimmarr%C3%ABse-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=0>

Për pyetjen se si realizohet ky bashkëpunim, ata përgjigjen se kryesisht bëhet përmes sekretarisë dhe organeve përkatëse, me afishime në faqet e internetit të secilit institucion dhe njoftime nga administrata. Për të rritur pjesëmarrjen, veprimet kryhen në bashkëpunim me ekzekutivin. Njoftimet për takimet informuese me qytetarët realizohen përmes *email*-it dhe *WhatsApp*-it nga ana e sekretarisë. Disa nga intervistuarit vënë në dukje rolin e drejtorive përkatëse dhe administratorëve rajonalë në koordinimin e këtij bashkëpunimi. Kjo strategji tregon një përpjekje të koordinuar për të përfshirë publikun dhe për të përmirësuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, megjithatë, ka nevojë për përmirësime në disa aspekte.

Gjatë vitit 2023, gjatë muajve të përfshirë në këtë periudhë monitorimi, janë realizuar konsultime publike për buxhetimin me pjesëmarrje nga Bashkia Korçë. Në këto konsultime kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Këshilli Bashkiak për konsultimin e formës finale të planit afatmesëm, për shkak të vështirësive në përfshirjen e qytetarëve. Megjithatë, takimi konsultues me Njësinë Administrative Qendër Korçë, i parashikuar në kalendarin e aktiviteteve, nuk është realizuar. Paketa fiskale për këtë vit është konsultuar me përfaqësues të grupeve të interesit nga sektori i turizmit.

Për vitin 2024, në regjistrin elektronik të Këshillit Bashkiak për konsultimet publike gjenden pesë projekt-akte. Nuk ka *linke* për rezultatet e takimeve për ato konsultime që janë realizuar. Në linkun që na është dërguar nga zyra e informimit të publikut, i cili i përket Programit të Transparencës, nuk ka procesverbale për takimet publike të realizuara në kuadër të projektakteve të sipërpërmendura.<sup>38</sup> Relacionet përkatëse ndodhen në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.

Për vitin 2024 janë realizuar konsultime publike si më poshtë:

- Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim me administratën e Bashkisë, realizoi konsultimin publik me edukatore dhe drejtuese të kopshteve për “Planin e përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor 2024-2026”.<sup>39</sup> Pjesë e konsultimit ishin edhe komuniteti (përfshirë anëtarë të grupeve vulnerabël), anëtarë të këshillave të prindërve dhe bordeve të kopshteve, për të marrë mendimin e tyre mbi këto plane, për të evidentuar dhe forcuar kontributin e bordit të prindërve dhe komunitetit në përgjithësi në zbatimin e tyre, dhe për të parë modele të mira menaxhimi për arsimin parashkollor dhe mekanizmat për t’i bërë funksionale ato.
- Janë përmbyllur seancat dëgjimore dhe konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Lekas, Vithkuq, Mollaj, Drenovë dhe Voskopojë,<sup>40</sup> për miratimin e vazhdimin të procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor për sipërfaqen pyjore e

<sup>38</sup><https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/procedura-e-marrjes-dhe-shqyrtimit-t%C3%AB-komenteve-dhe-rekomandimeve?authuser=0>

<sup>39</sup> <https://www.facebook.com/photo/?fbid=731175972551435&set=pcb.731176362551396>

<sup>40</sup> <https://www.facebook.com/photo/?fbid=780538454273256&set=pcb.780539260939842>

cila do t'ju nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor pranë fshatit Mazrekë.

- Referuar njoftimeve, është planifikuar të realizohet konsultimi publik më 16 korrik 2024 në kuadër të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, nga Bashkia Korçë dhe Këshilli i Bashkisë Korçë.

Në lidhje me programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, projektakti nuk është pasqyruar në regjistrin elektronik të konsultimeve publike të Këshillit Bashkiak Korçë.

Gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26 qershor 2024, nuk u arrit miratimi i pikës 9 të rendit të ditës “Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027, faza e parë”, çka çoi në mosmiratimin e programit. Këshilltarët e opozitës kërkuan marrjen e masave për fillimin e konsultimeve publike për dokumentin e këtij programi, të cilat, sipas tyre, duhej të kishin filluar që në fazën e parë, bazuar në kalendarin e planit të punës të Këshillit Bashkiak.

***Gjetje: Mosrespektimi i kalendarit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak për vitin 2024 për Konsultimin Publik mbi Hartimin e Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027***

### **Procedurat për iniciimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik dhe mjetet që përdoren për realizimin e tij**

Në lidhje me iniciimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, dy nga të intervistuarit nga stafi i Bashkisë pohuan se iniciimi bëhet nga Kryetari i Bashkisë, ndërsa një prej tyre pohon që iniciimi bëhet nga stafi. Pyetjes në lidhje me mjetet e njoftimit dhe konsultimit publik iu përgjigj vetëm koordinatorja e konsultimit publik, e cila njëkohësisht është edhe koordinatorja për të drejtën e informimit. Ajo konfirmoi se informacioni për njoftimin publik afishohet në stendën e Bashkisë, nëpërmjet regjistrin elektronik dhe publikimeve në rrjetet sociale.

Ajo gjithashtu nënvizoi përfshirjen e të gjitha drejtorive për një koordinim më të mirë dhe për të siguruar që Procesi i Njoftimit dhe Konsultimit Publik të jetë transparent dhe efektiv në të gjitha nivelet. Në anën tjetër, dy të intervistuarat e tjera nuk janë përgjegjës në lidhje me këto çështje dhe nuk kishin informacion se kush është koordinatorja e Konsultimit Publik. Gjithashtu, shumica e të intervistuarve nga Këshilli Bashkiak pohuan se përdoren të njëjtat forma njoftimi si më lart, si dhe njoftime individuale. Shumica pohuan se nuk bëhen njoftime në median vizive, me përjashtim të një anëtari nga pesë, i cili përmendi njoftimet në këtë media.

Gjithashtu, nga këto intervista na rezultojnë që:

- Ka një regjistër ose plan vjetor për Procesin e Vendimmarrjes me Pjesëmarrje, i cili përditësohet sistematikisht dhe përgjegjës për përditësimin e tij është koordinatorja

për Informimin Publik. Ky regjistër është publikuar online dhe procesverbali i takimeve dhe konsultimeve me publikun gjithmonë publikohet.

- Komentet dhe rekomandimet në Procesin e Konsultimit Publik merren në formë verbale dhe/ose shkrimore dhe regjistrohen në procesverbalet e takimeve publike, ku shpjegohen arsyet për nxjerrjen e projektaktit dhe ndikimi që ai do të ketë.
- Përcaktohen afati, vendi dhe mënyra për paraqitjen dhe dërgimin e rekomandimeve nga palët e interesuara, dhe adresat e kontaktit të koordinаторit për njoftimin dhe Konsultimin Publik afishohen/publikohen për mbledhjen e rekomandimeve dhe komenteve për projektaktin.

Megjithatë, në lidhje me pyetjen se kur publikohet vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij, nuk morëm përgjigje nga të intervistuarat nga stafi i Bashkisë.

Ndërkohë, për sa i përket disponueshmërisë së infrastrukturës për realizimin dhe mbikëqyrjen e procedurave ligjore për njoftimin dhe Konsultimin Publik, përgjigjet e anëtarëve të Këshillit Bashkiak shfaqin një gamë të ndryshme qëndrimesh. Dy anëtarë pohojnë se infrastruktura është e disponueshme. Në anën tjetër, disa nuk japin përgjigje ose përgjigjen "jo".

Në lidhje me këtë rubrikë, nga monitorimi që kemi bërë, kemi arritur në gjetjet e mëposhtme:

✓ ***Mungesa e publikimit të plotë të planeve vjetore në Programin e Transparencës<sup>41</sup>***

Sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", çdo organ publik ka detyrimin që në programet e transparencës të publikojë planet vjetore që lidhen me Procesin e Vendimmarrjes. Këto plane duhet të publikohen para fillimit të Procesit të Hartimit të Projektakteve dhe duhet të pasqyrojnë nismat përkatëse.

Duke iu referuar Programit të Transparencës së Bashkisë Korçë, u vu re se ishte publikuar vetëm plani i konsultimeve të Këshillit Bashkiak për periudhën janar-dhjetor 2023.

Ishin publikuar kalendarët e konsultimeve publike të zhvilluara për Paketën Fiskale dhe Buxhetimin me Pjesëmarrje nga Bashkia.

Plani i konsultimeve të Këshillit Bashkiak Korçë, vendimi për planin e aktiviteteve dhe konsultimeve publike për vitin 2023 dhe matrica e shpenzimeve korrente dhe investimeve me produktet përfundimtare për vitin 2023 ishin postuar edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë.<sup>42</sup>

Gjithashtu, koordinatori për të drejtën e informimit na dërgoi vendimin për planin e aktiviteteve dhe konsultimeve publike, si dhe planin e konsultimeve të Këshillit Bashkiak

<sup>41</sup> Programi i Transparencës, Bashkia Korçë: Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje  
<https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/plani-vjetor-p%C3%ABr-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=0>

<sup>42</sup> Plani i konsultimeve të Këshillit Bashkiak Korçë (janar-dhjetor 2023):  
<https://bashkiakor.gov.al/site/articles.php?cid=393&t=Plani-Vjetor-i-pun%C3%ABs-i-K%C3%ABshillit-Bashkiak>

Korçë për vitin 2024. Aktivitetet në këtë plan ishin informuese për këtë vit. Ky plan aktivitetesh nuk ishte botuar në Programin e Transparencës, por ndodhet bashkëngjitur vendimit përkatës të KB Korçë, publikuar në faqen online të Bashkisë ku publikohen projektvendimet.

Publikimi i pjesshëm i këtyre planeve tek Programi i Transparencës bie ndesh me detyrimet ligjore dhe kufizon mundësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në mënyrë të informuar në proceset e konsultimit publik dhe vendimmarrjes.

- ✓ ***Mospërdorimi i një forme të vetme të standardizuar për të gjitha njoftimet, që të përfshijë të gjitha informacionet e nevojshme për qytetarët.***<sup>43</sup>

Për këtë periudhë monitorimi, në regjistrin elektronik janë publikuar pesë projektakte. Njoftimet për konsultimet publike janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Tek njoftimet janë vendosur: titulli, propozuesi, sqarime për projektaktin, kalendari me datat përkatëse, linku i dokumentave për konsultim, pjesëmarrësit nga institucioni i bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, kush mund të marrë pjesë nga komuniteti, forma e konsultimit, qëllimi, përshkrimi i çështjeve që trajton konsultimi, pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut, ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme, kontakti me e-mail dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve dhe vërejtjeve, si dhe data e publikimit.

Ka raste kur njoftimet janë të shkurtra dhe nuk i përmbajnë të gjitha elementet e përshkruara më lart. Megjithatë, këto informacione pasqyrohen në kalendarët e Konsultimit Publik, të cilët janë të detajuar. Në këto kalendarë, mungojnë data e publikimeve dhe adresa *e-mail* ku mund të dërgohen komentet, rekomandimet dhe vërejtjet, si dhe afatet për dërgimin e tyre. Në lidhje me standardizimin e procedurës administrative të njoftimit dhe konsultimit publik, dy nga tre anëtarët e stafit të bashkisë të intervistuar thanë se procedura ishte e standardizuar, ndërsa njëri prej tyre nuk dha përgjigje.

- ✓ ***Mungesa e koordinatorit të dedikuar për Konsultimin Publik***

Detyra e Konsultimit Publik duket se kryhet nga përgjegjësia e sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, i cila gjithashtu mban pozicionin e Koordinatorit për Informimin Publik. Procesverbali i emërimit<sup>44</sup> i dërguar nga koordinataria përshkruante vetëm emërimin e Koordinatorit për Informimin Publik. Mungesa e një koordinatori të dedikuar për konsultimin publik tregon një mungesë të ndarjes së qartë të përgjegjësisive brenda strukturave të Bashkisë. Kjo mund të çojë në ngatërresa dhe ngadalësim në proceset e konsultimit publik. Një person i dedikuar për Konsultimin Publik do të ishte më i fokusuar dhe më i aftë për të menaxhuar dhe koordinuar proceset e konsultimit, duke siguruar që të gjitha detyrimet ligjore dhe administrative të përmbushen plotësisht. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e punës në të dyja fushat, duke rezultuar në konsultime më pak efektive dhe

<sup>43</sup> Regjistri i projekt akteve për konsultim publik, të Këshillit Bashkiak Korçë:

<https://docs.google.com/spreadsheets/d/1UYq08gHYMKzLUkpFPmSnrxxgp-eEa5kX1rW003cgW5c/edit#gid=0>

<sup>44</sup> Shtojca 3\_Urdhër emërimi

informim më pak të plotë. Gjithashtu, përqendrimi i përgjegjësive në një person të vetëm mund të krijojë perceptimin e mungesës së transparencës dhe përgjegjësisë, duke reduktuar besimin e qytetarëve në proceset e Bashkisë.

Dy nga tre anëtarët e stafit të Bashkisë të intervistuar nuk kanë informacion se kush është koordinatori për Konsultimin Publik. Kjo tregon se nuk ka një komunikim të qartë dhe efektiv ndërmjet stafit.

✓ **Mungesa e diversitetit në mënyrat e njoftimit gjatë procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Korçë**

Në Bashkinë Korçë, mënyra e njoftimit gjatë procesit të Konsultimit Publik realizohet përmes një lajmërimi publik, i cili afishohet në stendën e Bashkisë Korçë, publikohet në faqen zyrtare të internetit [www.bashkiakorce.gov.al](http://www.bashkiakorce.gov.al), në kategorinë "Njoftime" dhe faqet Facebook të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak. Kjo praktikë, megjithëse e disponueshme në rrjet, nuk përmbush të gjitha mundësitë e njoftimit të përcaktuara nga ligji për të siguruar një përfshirje sa më të gjerë dhe të drejtë të publikut në Procesin e Konsultimit Publik.

Ligji nuk e ka të parashikuar në mënyrë taksative përdorimin e të gjitha formave, por përdorimi i më shumë formave të njoftimit do të ndikonte pozitivisht në proces. Kjo mënyrë e kufizuar e njoftimit, e cila përdor vetëm afishimin fizik në stendën e Bashkisë dhe publikimin në faqen zyrtare të internetit, mund të kufizojë aksesin e qytetarëve dhe grupimeve të interesit që nuk kanë qasje të lehtë në këto burime. Në mungesë të një diversiteti të mënyrave të njoftimit, transparenca dhe pjesëmarrja e plotë e publikut në procesin e vendimmarrjes mund të jetë e prekshme.

✓ **Mungesa e diversitetit në mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Korçë**


Në Bashkinë Korçë, komentet dhe rekomandimet gjatë procesit të konsultimit publik merren në formë verbale dhe të shkruara, të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. Kjo metodë e përdorur për të kapur reagimet e publikut mund të limitojë pjesëmarrjen e atyre qytetarëve dhe grupimeve të interesit që preferojnë komunikimin në mënyra të tjera. Disa qytetarë nuk mund të marrin pjesë fizikisht në takime publike për shkaqe të ndryshme. Disa qytetarë të tjerë dhe grupime e kanë më të vështirë të shprehin mendimet e tyre dhe mundet të kontribuojnë në forma të tjera të preferuara për ata.

Përdorimi i kufizuar i mënyrave të marrjes së komenteve dhe rekomandimeve, duke u përqëndruar kryesisht në formën verbale dhe të shkruara të regjistruara në procesverbal, mund të kufizojë diversitetin dhe pjesëmarrjen e plotë të publikut në Procesin e Konsultimit Publik. Në këtë mënyrë, disa qytetarë dhe grupime e kanë më të vështirë të shprehin mendimet e tyre dhe të kontribuojnë në format e preferuara.

Ndërkohë, në pyetjen nëse Këshilli Bashkiak ka infrastrukturën e duhur për realizimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për njoftimin dhe Konsultimin Publik, 80% e këshilltarëve (4 nga 5) janë përgjigjur pozitivisht, një është përgjigjur negativisht.

✓ **Mungesa e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi të brendshëm të procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik**

Në pyetjen nëse Këshilli Bashkiak ka një mekanizëm monitorimi dhe raportimi për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, shumica e anëtarëve të intervistuar (3 nga 5) janë përgjigjur negativisht. Nga ana tjetër, nga stafi i Bashkisë, vetëm një nga tre të intervistuarit është përgjigjur pozitivisht, ndërsa dy të tjerë nuk kanë dhënë përgjigje.




Grafiku 1: Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit për Procesin e Konsultimit Publik

Të intervistuarit që kanë dhënë përgjigje pozitive kanë përmendur si shembuj monitorimin nga “Faktoje.al” dhe projektin “Bashki të Forta”, të cilët lidhen me monitorim të jashtëm. Nga intervistat rezulton se nuk ka statistika mbi përfshirjen e qytetarëve dhe se nuk ka një sistem të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi të Procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik. Edhe nga koordinatori e informimit në përgjigje të kërkesës sonë zyrtare, na është dërguar Raporti i Monitorimit të Transparencës dhe Konsultimit Publik për vitin 2023 nga Faktoje.al. Nuk na u dërgua raporti i kërkuar. Më poshtë janë disa pyetje dhe përgjigje që lidhen me transparencën e Procesit të Konsultimit Publik.




Grafiku 2: Procesi i ndjekjes së zbatimit të projektvendimeve



Grafiku 3: Indikatorët matës të monitorimit dhe vlerësimit

Këto rezultate nënvizojnë mungesën e një mekanizmi të brendshëm dhe sistematik për monitorimin dhe vlerësimin e Procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak Korçë. Varësia nga monitorimet e jashtme sugjeron një nevojë të domosdoshme për zhvillimin e kapaciteteve të brendshme për të siguruar transparencë dhe përfshirje efektive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Krijimi i një sistemi të brendshëm monitorimi do të ishte një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të këtyre proceseve dhe rritjes së llogaridhënies.

Pavarësisht faktit që ka një raport të jashtëm monitorimi të transparencës, është i domosdoshëm edhe raporti i Bashkisë për disa arsye kryesore. Ndërsa raporti i Faktoje.al është një burim i vlefshëm dhe i rëndësishëm për të vlerësuar transparencën e Bashkisë Korçë nga një perspektivë e jashtme, raporti i Bashkisë përmban informacione specifike dhe të detajuara mbi veprimtaritë dhe nismat e brendshme të ndërmarra nga Bashkia për të përmirësuar transparencën. Ai ofron një pamje më të plotë dhe më të thelluar të përpjekjeve dhe rezultateve të institucionit. Raporti i brendshëm është një mjet kritik për identifikimin e mangësive dhe përcaktimin e fushave ku këto institucione lokale mund të përmirësohen. Ai mund të përmbajë rekomandime të brendshme dhe një plan veprimi për vitin e ardhshëm, duke ndihmuar në zhvillimin dhe zbatimin e politikave më efektive të transparencës. Gjithashtu raportim i brendshëm ndihmon në koordinimin dhe konsistencën e përpjekjeve të ndryshme për transparencë brenda institucionit. Ai siguron që të gjitha departamentet dhe drejtoritë të jenë në një linjë dhe të punojnë së bashku drejt objektivave të përbashkëta të transparencës dhe rrit besimin e qytetarëve për institucionin.




Grafiku 4: Raportimi në Këshillin Bashkiak mbi proceset që rrjedhin nga Ligji nr.146/2014



Në mbledhjen e KB më datë 25 janar 2024, këshilltarët janë informuar mbi Raportin e Performancës së Këshillit Bashkiak 2023. Ky raport nuk është publikuar në faqen e dedikuar në *web*-in e Bashkisë për këtë vit.<sup>45</sup>

✓ **Mungesa e ankesave të drejtpërdrejta në lidhje me konsultimin publik**

Në faqen e Bashkisë Korçë janë publikuar Rregullorja e Këshillit Bashkiak për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare<sup>46</sup>, si dhe Regjistri i Ankesave dhe Kërkesave drejtuar Këshillit Bashkiak Korçë.<sup>47</sup> Megjithatë, është vërejtur se regjistri përmban ankesa lidhur me problematika të ndryshme, por jo me konsultimin publik.



Numri i ankesave të raportuara në dy vitet e fundit tregon variacione të konsiderueshme dhe mungesë konsistence në raportime ndërmjet zyrtarëve të ndryshëm të Këshillit Bashkiak, ndoshta arrin deri në 100.

Grafiku 5: Ankesat nga qytetarët/grupe interesi lidhur me Konsultimin Publik

Në lidhje me këtë duhet të konsiderohet se:

- Procesi i Konsultimit Publik mund të jetë efektiv dhe të mos ketë probleme reale.
- Qytetarët mund të mos jenë të informuar mirë për mënyrën e paraqitjes së ankesave për konsultimet publike.
- Qytetarët mund të kenë mungesë besimi në sistemin e ankimimit.

<sup>45</sup> Raporte vjetore të Këshillit Bashkiak Korçë.

<https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=301&t=Raportet-e-Performanc%C3%ABs>

<sup>46</sup> Rregullorja e Këshillit Bashkiak për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare

<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/RREGULLORE%20E%20K.B%20PARAQITJA%20DHE%20SHQYRTIMI%20I%20ANKESAVE%2C%20VEREJTJEVE%2C%20KERKESAVE%2C%20PETICIONEVE%20DHE%20INICIATIVAVE%20QYTETARE%20%281%29%20%281%29.pdf>

<sup>47</sup> Regjistri i ankesave dhe kërkesave drejtuar Këshillit Bashkiak Korçë <https://docs.google.com/spreadsheets/d/1Fs-zboxMCDYRacqu6VIX-09TFckh95Ff5eXrZLvkvD0/edit?gid=0#gid=0>

✓ **Mungesa e besimit të qytetarëve: Aktivizmi qytetar nuk është rritur në nivelin e duhur.**

Bazuar në mendimet e intervistuarve, pjesëmarrja e qytetarëve është një sfidë kryesore në Proceset e Konsultimit Publik. Pjesa e tyre në këto procese është e kufizuar, duke shfaqur mungesën e besimit të tyre në rezultatit e këtyre konsultimeve. Sfidat përfshijnë angazhimin e pakët të komisioneve përkatëse dhe mungesën e një komunikimi efektiv dhe transparent me qytetarët. Si zgjidhje të mundshme, propozohen sesione informimi dhe ndërgjegjësimi për qytetarët, trajnim i vazhdueshëm për rritjen e kapaciteteve të Këshillit Bashkiak dhe sensibilizimi i këshilltarëve për të marrë pjesë aktivisht në Proceset e Konsultimit Publik.

✓ **Mungesa e rishikimit të Programit të Transparencës në Bashkinë Korçë**

Bashkia Korçë nuk ka ndërmarrë procedurat për Miratimin e Rishikimit të Programit të Transparencës, një dokument thelbësor që pritet të përmirësojë ndërveprimin me qytetarët. Ky rishikim është i domosdoshëm për t'u përshtatur me kërkesat dhe detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 119/2014, Neni 5, pika 2<sup>48</sup>, gjithashtu me shkresën nr. 3570, datë 6.03.2024 e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

*Më poshtë paraqitet në mënyrë të sintetizuar informacionin e marrë nga Bashkia, të krahasuar me rezultatet e dala nga monitorimi dhe komentet përkatëse në lidhje me gjetjet e mësipërme.*

Kërkesa për informacion	Pergjigjet zyrtare nga Bashkia Korçë dhe Këshilli Bashkiak	Komente / Mjetet e verifikimit	Vlerësimi
1.Emri, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në Bashkinë Korçë është Znj. Larisa Katundi E-mail: <a href="mailto:larisakatundi5@gmail.com">larisakatundi5@gmail.com</a>  Tek <a href="#">linku</a> më poshtë është publikuar emër mbiemër i koordinatorit dhe adresa e-mail.  <a href="https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimarrje/t%C3%AB-dh%C3%ABnat-e-koordinatorit-">https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimarrje/t%C3%AB-dh%C3%ABnat-e-koordinatorit-</a>	Për të marrë informacion mbi emërimin e koordinatorit për Konsultimin Publik, dorëzuam në Bashki një kërkesë zyrtare. Në përgjigjen e , na u dërgua Urdhri Nr. 157, datë 12.09.2016, për emërimin e koordinatorës për Informimin Publik, e cila mbante edhe funksionin e drejtoreshës së Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar. Sipas të dhënave tek Programi i Transparencës, i njëjti person mban edhe detyrën e Koordinatorit për Konsultimin Publik. Urdhërat e brendshëm për vitet 2023 dhe 2024 (Urdhri Nr. 815, datë 16.08.2023, dhe	Pjesërisht i realizuar

<sup>48</sup> Ligjin Nr. 119/2014, Neni 5, pika 2: Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.  
[https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj\\_119\\_2014\\_18.09.2014.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf)

	<a href="#">p%C3%ABr-njoftimin-dhe-konsultimin-publik</a>	Urdhri Nr. 32, datë 17.01.2024) konfirmojnë se Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar është zëvendësuar nga një sektor me të njëjtin emërtim, i cili ka një përgjegjës sektori. Ky ristrukturim tregon një mungesë të qartë të fokusit në Konsultimin Publik dhe thekson nevojën për përcaktimin e qartë të përgjegjësive dhe detyrave për koordinatorin e Konsultimit Publik dhe informimin qytetar, për të siguruar një proces vendimmarrjeje të hapur dhe pjesëmarrës. Urdhër për miratimin e strukturës së administratës të Bashkisë Korçë për vitin 2024. <a href="https://drive.google.com/file/d/1ZluLJ_ZEvLFtdEnaihDCZ3aR9LbrC35M/view">https://drive.google.com/file/d/1ZluLJ_ZEvLFtdEnaihDCZ3aR9LbrC35M/view</a>	
2. Linku i Regjistrimit Elektronik ku janë publikuar projektaktet, e Njoftimit për konsultim dhe të dhëna të lidhura me Konsultimin e Projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.	Në përgjigjen zyrtare të Bashkisë është dërguar <i>linku</i> i Regjistrimit Elektronik i projektakteve për Konsultim Publik, të Këshillit Bashkiak Korçë:  <a href="https://docs.google.com/spreadsheets/d/1UYq08gHYMKzLUkpFPmSmrxxgp-eEa5kX1rW003cgW5c/edit#gid=0">https://docs.google.com/spreadsheets/d/1UYq08gHYMKzLUkpFPmSmrxxgp-eEa5kX1rW003cgW5c/edit#gid=0</a>		I realizuar plotësisht
3. Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me Procesin e Vendimmarrjes, të publikuara në Programin e Transparencës, sipas Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”	Në përgjigje të kërkesës sonë nga Bashkia na është dërguar:  1. <i>Linku</i> ku publikohen planet vjetore, pjesë e Programit të Transparencës.  <a href="https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/plani-vjetor-p%C3%ABr-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=0">https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/plani-vjetor-p%C3%ABr-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=0</a>	Tek ky <i>link</i> gjenden:  Vendimi për planin e aktiviteteve dhe Konsultimeve Publike për vitin 2023 të KB dhe matrica e shpenzimeve korrente dhe investimeve me produktet përfundimtare për vitin 2023. Ndodhen të publikuara edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. <a href="https://bashkiakor.gov.al/site/articles.php?cid=393&amp;t=Plani-Vjetor-i-pun%C3%ABs-i-K%C3%ABshillit-Bashkiak">https://bashkiakor.gov.al/site/articles.php?cid=393&amp;t=Plani-Vjetor-i-pun%C3%ABs-i-K%C3%ABshillit-Bashkiak</a> Ky <i>link</i> është i botuar tek Programi i Transparencës, tek fusha përkatëse.  Janë publikuar kalendarët e Konsultimeve Publike për vitin 2023 nga Institucioni i Bashkisë (Buxhetimi me Pjesëmarrje, nga viti 2017-2023), tek Programi i Transparencës.	Pjesërisht i realizuar

	<p>2. VKB-ja Nr.156 datë 07.12.2023, "Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe planit të Konsultimeve Publike 2024 të Këshillit Bashkiak Korçë"</p> <p>3. VKB-ja Nr.10 datë 25.01.2024 "Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionet e Bashkisë Korçë për vitin 2024".</p>	<p><a href="https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarria-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrie/plani-vjetor-p%C3%ABr-procesin-e-vendimmarries-me-pjes%C3%ABmarrie">https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarria-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrie/plani-vjetor-p%C3%ABr-procesin-e-vendimmarries-me-pjes%C3%ABmarrie</a></p> <p>Nuk është pjesë e këtij kalendari takimi për konsultimin e Paketës Fiskale, pavarisht që është realizuar si takim me grupe interesi nga biznesi.</p> <p>Plani i aktiviteteve është i publikuar në faqen e Bashkisë Korçë, bashkëngjitur VKB-së përkatëse. Ky plan përmban kalendarin e aktiviteteve me bazë mujore: <a href="https://bashkiakor.gov.al/files4users/files/Vendimi-Nr.156%281%29.pdf">https://bashkiakor.gov.al/files4users/files/Vendimi-Nr.156%281%29.pdf</a></p> <p>Nuk është botuar tek Programii i Transparencës, tek fusha përkatëse.</p> <p>Dokumentat përkatëse janë botuar tek faqia web e Bashkisë. <a href="https://bashkiakor.gov.al/site/articles.php?cid=234&amp;t=Vendime">https://bashkiakor.gov.al/site/articles.php?cid=234&amp;t=Vendime</a></p>	
<p>4. Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të Konsultimit Publik që rekomandohen të kryen nga Bashkia.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•me postë elektronike;</li> <li>•me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;</li> <li>•me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;</li> <li>•me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në</li> </ul>	<p>Nga përgjigjet mënyrat e njoftimit janë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- afishime në stendën e Bashkisë;</li> <li>- nëpërmjet Regjistrat Elektronik;</li> <li>- publikime në rrjetet <i>sociale</i>;</li> <li>- njoftime individuale;</li> <li>- në faqen e internetit të Bashkisë, tek kategoria "Njoftime".</li> </ul>	<p>Nga monitorimi rezulton se sidomos në NJA-të në zonat rurale njoftimet bëhen edhe direkt nga Kryeplaku i Fshatit.</p> <p>Nuk bëhen njoftime në mediat <i>audiovizive</i> dhe gazeta. Nuk është detyrim ligjor, por është i rekomanduar.</p>	<p>I realizuar plotësisht</p>

nivel kombëtar			
5. Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve e gjatë Procesit të Konsultimit publik: •me postë elektronike; •në formë verbale dhe/ose me shkrime të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. •Tjetër	Sipas Bashkisë Korçë, komentet dhe rekomandimet merren në formë verbale dhe me shkrim të regjistruara në Procesverbalin e Takimeve Publike.	Nga monitorimi në shumicën e njoftimeve është vendosur një adresë <i>e-mail</i> për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të Konsultimit Publik.	I realizuar plotësisht
6. A ka patur raste kur është zgatur ose përsëritur faza e konsultimit?	Sipas përgjigjes së Bashkisë nuk ka patur raste të përsëritjes së fazës së Konsultimit Publik. Kjo përgjigje është e vlefshme deri në datë 28 maj 2024, data kur ne morrëm përgjigjet zyrtare nga Bashkia në lidhje me kërkesat për informacion që ne kishim dërguar.	Nga monitorimi na rezulton si më poshtë:  Në lidhje me programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, projektakti nuk është pasqyruar në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike të Këshillit Bashkiak Korçë. Gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26 qershor 2024, nuk u arrit miratimi i pikës 9 të rendit të ditës "Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, faza e parë", çka çoi në mosmiratimin e programit.	Pjesërisht i realizuar
7. Nese Po ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgatur ose përsëritur faza e konsultimit	Nuk është i aplikueshëm deri në datë 28 maj 2024, pasi deri në datën e kthimit të përgjigjes nga Bashkia nuk ka patur raste të përsëritjes së fazës së Konsultimit Publik.	Si më lart gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26 qershor 2024, nuk u arrit miratimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, faza e parë". Këshilltarët e Opozitës kërkuan marrjen e masave për fillimin e Konsultimeve Publike për dokumentin e këtij programi, të cilat duhej të kishin filluar që në fazën e parë, bazuar në kalendarin e planit të punës të Këshillit Bashkiak. Transmetimi <i>live</i> i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26 qershor 2024. <a href="https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce/videos/1006333300546774">https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce/videos/1006333300546774</a>	Pjesërisht i realizuar
8. Kopje të njoftimit për takime publike	Përgjigjia nga Bashkia: 1. Njoftimi për Konsultimet Publike bëhet në kategorinë "Njoftime", në faqen zyrtare të Bashkisë. <a href="http://www.bashkiakorçe.gov.al">www.bashkiakorçe.gov.al</a> 2. Kategoria Njoftime tek rubrika "Këshilli Bashkiak",	Nga monitorimi njoftimet për Konsultimet Publike janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Këto njoftime përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm.  Ka raste kur njoftimet janë më të shkurtra dhe nuk i përmbajnë të gjitha elementet, megjithatë, këto informacione pasqyrohen në	Pjesërisht i realizuar

	<p><i>link-u bashkëngjitur:</i> <a href="https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet">https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet</a></p> <p>3. Gjithashtu, në Programi i Transparencës <i>link-u bashkëngjitur:</i> <a href="https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qtetare-n%C3%AB-vendimmarrje/njoftimi-p%C3%ABr-nism%C3%ABn-vendimmarr%C3%ABse-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=0">https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qtetare-n%C3%AB-vendimmarrje/njoftimi-p%C3%ABr-nism%C3%ABn-vendimmarr%C3%ABse-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=0</a></p>	<p>kalendarët e Konsultimit Publik, të cilët janë të detajuar. Në këto raste mungojnë data e publikimeve dhe adresa e-mail ku mund të dërgohen komentet, rekomandimet dhe vërejtjet, si dhe afatet për dërgimin e tyre.</p> <p>Është e nevojshme standardizimi i procedurës administrative të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.</p> <p>Nga verifikimi tek Programi i Transparencës për vitet 2023-2024 gjendet i publikuar vetëm një njoftim, datë 21.11.2023. <a href="https://docs.google.com/document/d/1jYHGJ4lDev5fGGcwg3BZ1e705jyuFndc/edit">https://docs.google.com/document/d/1jYHGJ4lDev5fGGcwg3BZ1e705jyuFndc/edit</a></p> <p>Më poshtë njoftimet dhe modelet si shpërndahen njoftimet për dëgjesat publike në faqen <i>web</i> të Bashkisë Korçë, për këtë periudhë raportimi:</p> <p>Njoftim për Sondazh për prioritetet e qytetarëve në lidhje me Buxhetin 2024: <a href="https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=409&amp;t=Sondazhe">https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=409&amp;t=Sondazhe</a></p> <p>Njoftim për Konsultim Publik për PBA 2024-2026, Paketen Fiskale 2024 dhe Buxhetin 2024: <a href="https://bashkiakorke.gov.al/site/article.php?aid=4687&amp;t=Njoftim-p%C3%ABr-konsultim-publik">https://bashkiakorke.gov.al/site/article.php?aid=4687&amp;t=Njoftim-p%C3%ABr-konsultim-publik</a></p> <p>NJOFTIM për kalendarin e konsultimeve publike nga KB. <a href="https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimett&amp;page=3">https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimett&amp;page=3</a></p> <p>Njoftim, kalendari i Konsultimeve Publike: <a href="https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimett&amp;page=3">https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimett&amp;page=3</a></p> <p>Njoftim dhe informim për qytetarët nëpërmjet një video informuese dhe promovuese se si të paraqesin ankesat, rekomandimet e tyre dhe të bëhen pjesë e konsultimeve publike: <a href="https://bashkiakorke.gov.al/files4users/files/WhatsApp%20Video%202023-10-26%20at%2010.04.26.mp4">https://bashkiakorke.gov.al/files4users/files/WhatsApp%20Video%202023-10-26%20at%2010.04.26.mp4</a></p> <p>Njoftim për Konsultim Publik për Projektaktin “PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË KORÇË” (mbledhja e rekomandimeve nëpërmjet postës elektronike): <a href="https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimett&amp;page=2">https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimett&amp;page=2</a></p> <p>Njoftim për Konsultim Publik për: Plani</p>	
--	--	---	--

		<p>Vendor i Veprimit për Energjinë dhe Klimën të Bashkisë Korçë Periudha: 2023-2040: <a href="https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet">https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet</a></p> <p>Njoftim për Konsultim Public për mbledhjen e rekomandimeve për projektaktin “PLANI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR 2024-2026”: <a href="https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimett&amp;page=2">https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimett&amp;page=2</a></p> <p>Njoftim për Konsultim Publik për Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Energjinë dhe Klimën 2023-2040. <a href="https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet">https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet</a></p> <p>Njoftim për HEC Mazreke: <a href="https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?id=388&amp;t=Njoftimet">https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?id=388&amp;t=Njoftimet</a></p>	
9. Kopje të procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës shtator 2023 – maj 2024	<p>Nga Bashkia është dërguar <i>link-u</i> në vazhdim ku publikohen procesverbalet (Programi i Transparencës): <a href="https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja- qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/procedura-e-marrjes-dhe-shqyrtimit-t%C3%AB-komenteve-dhe-rekomandimeve?authuser=0">https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja- qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/procedura-e-marrjes-dhe-shqyrtimit-t%C3%AB-komenteve-dhe-rekomandimeve?authuser=0</a></p>	<p>Nga monitorimi na rezulton se në këtë <i>link</i>, për periudhën e monitorimit, janë publikuar vetëm procesverbalet e mbajtura për buxhetimin me pjesëmarrje dhe Paketën Fiskale 2023.</p>	Pjesërisht i realizuar
10. Kopje të projektakteve të miratuara gjatë periudhës shtator 2023 – maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 146/2014 “Për	<p>Përgjigjja nga Bashkia: Projektaktet e miratuara janë të publikuara në <a href="https://www.vendime.al/korce/">vendime.al</a>. Link-u bashkëngjitur: <a href="https://www.vendime.al/korce/">https://www.vendime.al/korce/</a></p> <p>Më poshtë rendisim disa nga projektaktet e miratuara në Këshillin Bashkiak (projektvendimet), të cilat mund të gjenden në link-un e faqes zyrtare të Bashkisë Korçë si më poshtë: <a href="https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=419&amp;t=Projekt-Vendime">https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=419&amp;t=Projekt-Vendime</a></p> <p>PROJEKTVENDIM “MBI MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026”, të rishikuar: <a href="https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/7.relacion%20per%20miratimin%20e%20PBA%202024-">https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/7.relacion%20per%20miratimin%20e%20PBA%202024-</a></p>	<p>Mungon informacioni që shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.</p>	Pjesërisht i realizuar

<p>Njoftimin dhe Konsultimin Publik”</p>	<p><a href="#">2026%20faza%20e%20dyte.pdf</a> PROJEKTVENDIM “PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024” <a href="https://bashkiakorces.gov.al/files4users/files/6.projektvendim%20paketa%20fiskale%202024.pdf">https://bashkiakorces.gov.al/files4users/files/6.projektvendim%20paketa%20fiskale%202024.pdf</a> PROJEKTVENDIM “PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL, 2024-2027, BASHKIA KORÇË”. <a href="https://bashkiakorces.gov.al/files4users/files/4.0PROJEKT%20VENDIM%20PLAN%20SOCIAL%202024-2027.pdf">https://bashkiakorces.gov.al/files4users/files/4.0PROJEKT%20VENDIM%20PLAN%20SOCIAL%202024-2027.pdf</a> PROJEKTVENDIM “MBI MIRATIMIN E PROJEKT BUXHETIT VJETOR TË VITIT 2024 DHE PBA 2024-2026 TË BASHKISË KORÇË” <a href="https://bashkiakorces.gov.al/files4users/files/7.0Projekt%20vendimi%202024.pdf">https://bashkiakorces.gov.al/files4users/files/7.0Projekt%20vendimi%202024.pdf</a> etj.</p>		
<p>11. Kopje të Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023</p>	<p>Bashkia, në përgjigje të kësaj kërkesë, na ka dërguar një kopje të "Raportit vjetor për transparencën" nga Faktoje.al.</p>	<p>Në mbledhjen e KB më datë 25 janar 2024, këshilltarët janë informuar mbi Raportin e Performancës së Këshillit Bashkiak 2023. Ky raport nuk është publikuar në faqen e dedikuar në <i>web-in</i> e Bashkisë për këtë vit. Raporte vjetore të Këshillit Bashkiak Korçë. <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/articles.php?cid=301&amp;t=Raportet-e-Performanc%C3%ABs">https://bashkiakorces.gov.al/site/articles.php?cid=301&amp;t=Raportet-e-Performanc%C3%ABs</a></p>	<p>Pjesërisht i realizuar</p>
<p>12. Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për Njoftim dhe Konsultim Publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.</p>	<p>Në institucion nuk ka të depozituar ankesa në lidhje me procesin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.</p>	<p>Nga qytetarët apo grupet e interesit nuk ka ankesa për procesin e realizuar në periudhën shtator 2023– maj 2024. Nga monitorimi është vërejtur se regjistri përmban ankesa lidhur me problematika të ndryshme, por jo me Konsultimin Publik.</p>	<p>I realizuar plotësisht</p>




## PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT DHE QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIK


Në kuadër të këtij studimi, janë zhvilluar gjithashtu 30 intervista të thelluara me aktivistë dhe përfaqësues të komunitetit, si dhe qytetarë nga grupet e interesit, ndërsa 104 qytetarë të Bashkisë së Korçës kanë plotësuar një pyetësor online. Pyetësorët përfshinin pyetje në lidhje me tema të ndryshme të Konsultimit Publik, siç janë: udhëzimet për fillimin e procedurave të Konsultimit Publik, përgatitjen dhe publikimin e kalendarit të Konsultimit Publik, njoftimin e Konsultimit Publik, realizimin e konsultimit, përgatitjen dhe publikimin e procesverbaleve, ndikimin e rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimmarrësit, si dhe publikimin e Raportit të Konsultimit Publik në regjistrin elektronik. Përmes këtyre pyetësorëve, është vlerësuar perceptimi i qytetarëve i efektivitetit të procesit të Konsultimit Publik në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupet e interesit, si dhe ndikimi i tyre në vendimet që nuk janë të përfshira në proceset pjesëmarrëse të jetës qytetare.

### Rezultatet e pyetësorit plotësuar online nga qytetarët

Pyetësori i plotësuar nga 104 qytetarë të bashkisë Korçë ka ofruar një pasqyrë të rëndësishme mbi perceptimet dhe përvojat e tyre lidhur me Procesin e Konsultimit Publik. Në total, 80 qytetarë nga zonat urbane (76%) dhe 24 qytetarë nga zonat rurale (24%) morën pjesë në plotësimin e pyetësorit. Ky shpërndarje demografike tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve vijnë nga zona urbane, duke reflektuar një përqendrim më të madh të popullsisë dhe ndoshta një ndërgjegjësim më të madh për Proceset e Informimit dhe Konsultimit Publik në këto zona. Nga të anketuarit, shumica janë femra (77%), ndërsa meshkujt përbëjnë 23% të të anketuarve. Kjo tregon një përfshirje më të madhe të femrave në procesin e plotësimit të pyetësorit.




Grafiku 6: Ndarja gjinore




Grafiku 7: Ndarja sipas zonave

Të anketuarit janë të ndarë në grupe moshore të ndryshme, me shumicën e tyre në grupmoshën 30-45 vjeç për femrat dhe grupmoshën 15-29 vjeç për meshkujt. Vetëm 23% i perkasin moshës nga 46-65 vjeç, dhe vetëm 1 person i moshës mbi 65 vjeç. Kjo tregon një përfaqësim të ulët të pjesëmarrjes së individëve më të moshuar në anketë, ndërsa grupet më të reja janë më shumë të përfshira. Kjo edhe për faktin se individët më të rinj shpesh kanë më shumë qasje dhe përdorim të teknologjisë, përfshirë internetin dhe rrjetet sociale.




*Grafiku 8: Ndarja sipas grupmoshave, Korçë*

Vetëm 47.1% e të anketuarve pohojnë se kanë njohuri mbi Ligjin për Konsultimin Publik, ndërsa 52.9% shprehen se nuk e njohin. Kjo tregon një mungesë të konsiderueshme të informimit dhe ndërgjegjësimit mbi legjislacionin për Konsultimin Publik në mesin e qytetarëve. Kjo mungesë njohurie mund të pengojë pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset vendimmarrëse dhe të kufizojë mundësitë për të ndikuar në politikat dhe vendimet që i prekin drejtpërdrejt. Përmirësimi i fushatave informuese dhe edukative rreth ligjit për konsultimin publik është thelbësor për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen qytetare.




Grafiku 9: Ndarja sipas grupmoshave, Korçë

Sipas grafikut të mëposhtëm, pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar pohojnë se janë informuar për dëgjesat publike përmes mediave sociale, njoftimeve individuale dhe lajmërimeve të afishuara në ambientet e Bashkisë. Një përqindje më e vogël pohon se janë lajmëruar nga Administratori apo Kryeplaku i Fshatit ose përmes postës elektronike. Ajo që tërheq vëmendje është fakti që një pjesë e qytetarëve pohon se janë njoftuar përmes mediave audio-vizive, megjithëse nga monitorimi ynë rezulton se ky burim informacioni nuk përdoret. Kjo tregon një konfuzion apo mospërputhje në burimet e informimit, dhe mund të sugjerojë se qytetarët nuk janë plotësisht të qartë mbi burimet reale të informacionit që përdoren për njoftimet publike.



Grafiku 10. Njoftimi për dëgjesat publike

Një nga gjetjet më të rëndësishme të pyetësorit është se pjesa më e madhe e qytetarëve nuk kanë marrë pjesë në dëgjesat publike të organizuara nga Bashkia apo Këshilli Bashkiak




(74.04%) në këto dy vitet e fundit. Nga ata që kanë marrë pjesë, shumë pak kanë dhënë rekomandime apo propozime. Shumica e atyre që nuk kanë marrë pjesë shprehen se nuk janë informuar, por nuk mungojnë edhe përgjigjet që deklarojnë mungesë interesi. Ky fakt nënvizon një shkallë të ulët të angazhimit qytetar në këto procese, një problem që duhet adresuar për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe përfshirjen qytetare.

Grafiku 11. Pjesëmarrja në dëgjesat e organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak në dy vitet e fundit

Shumica e të anketuarve (75.96%) besojnë se procedurat e konsultimit publik mund të përmirësojnë vendimmarrjen. Vetëm 15.38% kanë pohuar se nuk mendojnë kështu, ndërsa 8.66% nuk kanë dhënë një përgjigje. Ky rezultat tregon një perceptim pozitiv mbi rëndësinë e këtyre procedurave dhe nënvizon nevojën për zbatimin e tyre më efektiv.


Përqindja e lartë e atyre që shprehen në favor sugjeron një vullnet të qartë për pjesëmarrje aktive dhe kontribuim në proceset vendimmarrëse, gjë që autoritetet lokale duhet ta marrin parasysh për të rritur transparencën dhe përfshirjen qytetare.



Grafiku 12. Besimi në Përmirësimin e Vendimmarrjes përmes Procedurave të Konsultimit Publik

## Rezultatet e anketimit me grupet e interesit

Janë zhvilluar 30 intervista të thelluara (16 F/14M) me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (7 intervista me përfaqësues të OSHC-ve (5 F/2 M), 9 biznese (4F/5M), 14(7F/7M) aktivistë të shoqërisë civile dhe qytetarë nga grupet e interesit).



Grafiku 13: Pjesëmarrja në anketimin me grupet e interesit

Nga 30 të intervistuar, 28 (93.3%) pohojnë se janë të informuar lidhur me të drejtat e tyre për të marrë pjesë në njoftimin dhe konsultimin publik që organizon Bashkia ose Këshilli Bashkiak për vendimmarrje të ndryshme që prekin jetën e komunitetit ku ata bëjnë pjesë. Ky rezultat tregon një nivel të lartë të ndërgjegjësimit qytetar për të drejtat e tyre demokratike dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse.



Ky fakt është inkurajues dhe sugjeron që autoritetet lokale duhet të vazhdojnë dhe të përforcojnë përpjekjet për informimin dhe përfshirjen e qytetarëve në këto procese, për të siguruar një qeverisje më transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Grafiku 14: Njohuri mbi të drejtat për të marrë pjesë në Njoftimin dhe Konsultimin Publik

73.3 % e të intervistuarve pohojnë se marrin njoftime kryesisht nga mediat sociale si *Facebook* dhe *Instagram*. 93.3% pohojnë se shumë rrallë ose ndonjëherë informohen nga regjistri elektronik ose faqja e internetit. Për më tepër, rreth 53.3% e të intervistuarve pohojnë se nuk marrin njoftime përmes postës elektronike (*e-mail*) dhe asnjëherë nuk informohen përmes botimeve në gazetatat lokale ose nga administratori, Kryeplaku, Ndërlidhësi Komunitar, etj.



Lajmërimet individuale merren shumë rrallë ose ndonjëherë. Ekziston një shpërndarje e barabartë e përgjigjeve lidhur me lajmërimet publike të afishuara në ambientet e Bashkisë, ku disa pohojnë se nuk informohen ose informohen shumë rrallë, ndërsa të tjerët informohen gjithmonë.

Grafiku 15: Mënyrat e informimit

Duke ju referuar çka më lart duhet theksuar se, nga monitorimi ynë, Bashkia Korçë nuk ka ndërlidhës komunitarë. Gjithashtu, nga monitorimi rezulton se në zonat rurale, informimi bëhet gjithmonë nga Kryeplaku përmes lajmërimeve individuale, por të intervistuarit e këtij grupi i përkisnin qytetit të Korçës dhe pak aktivistëve nga zonat rurale.

Ky rezultat tregon një preferencë dhe mbështetje të fortë ndaj mediave sociale si burim informacioni, ndërsa kanalet e tjera janë më pak të përdorura.

53% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë marrë pjesë në dëgjesat publike.




Nga pjesa tjetër, 34.5% e të anketuarve pohojnë se kanë marrë pjesë shumë rrallë ose ndonjëherë dhe ndonjëherë kanë dhënë rekomandime/propozime, ndërsa një pjesë shumë e vogël, 12.5%, deklaroi se ka marrë pjesë shpesh dhe se gjithmonë kanë dhënë rekomandime/propozime.

Grafiku 16: Pjesë në konsultimet publike

Sa i përket bashkëpunimit me Bashkinë ose Këshillin Bashkiak, 62.5% e të anketuarve pranojnë se nuk kanë pasur raste bashkëpunimi, ndërsa 37.5% pohojnë se kanë pasur raste bashkëpunimi. Nga 20 të intervistuar që pranojnë se kanë pasur raste bashkëpunimi, 55% besojnë se rekomandimet e tyre u janë marrë parasysh. (vetëm 36.7% e të intervistuarve). Janë shumica (56,3%) e të anketuarve që pohojnë se është stafi i Bashkisë, që ka iniciuar procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe pjesa tjetër e të anketuarve të shpërndarë në mënyrë të barabartë, mendojnë që janë Këshilli i Bashkisë dhe projekte të realizuara në bashkëpunim me donatorë, apo të tjerë iniciues.

68,8% e të anketuarve pranojnë se u janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai ka në Procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, ndërsa 31,3% nuk mendojnë se u janë shpjeguar arsyet. Shumica e të intervistuarve (80%) pohojnë se u është shpjeguar afati, vendi dhe mënyra me të cilën, do të paraqesin ose do të dërgojnë rekomandimet e tyre.



*Grafiku 17 : Afati, vendi dhe mënyra e paraqitjes ose dërgimit të rekomandimeve*

Shumica e të anketuarve (62.5%) pohojnë se u është treguar ose publikuar adresa e kontaktit të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për mbledhjen e rekomandimeve dhe komenteve për projektaktin, ndërsa pjesa tjetër (37.5%) pranojnë se nuk u është treguar apo publikuar adresa e kontaktit.


Nga përgjigjet e të anketuarve konstatohet se pothuajse të gjithë të anketuarit nuk kanë informacion të saktë lidhur me kohën në dispozicion për të marrë pjesë në një konsultim publik.

Vetëm 36.7% e të intervistuarve beson se rekomandimet e tyre janë marrë parasysh ose nuk janë marrë parasysh. Një pjesë e vogël e të intervistuarve shprehen se nuk e dinë.

Shumë pak besojnë se konsultimet publike kanë forcën e duhur për të sjellë ndryshime reale.

Në pyetjen nëse gjatë konsultimeve publike të organizuara janë vënë në dispozicion materiale të projektaktit për shqyrtim dhe dhënie rekomandimesh, nuk ka përgjigje nga të intervistuarit. Kjo mungesë përgjigjesh mund të sugjerojë një mungesë transparence ose komunikimi efektiv në këtë aspekt të procesit të konsultimit publik.

*Nëse nuk keni qenë dakord me projektaktin dhe keni dhënë rekomandime, komente e vërejtje, a keni patur kohë në dispozicion për t'i referuar dhe cila është rruga që keni ndjekur më poshtë?* Në lidhje me këtë pyetje shumica e të intervistuarve janë shprehur se kanë ndjekur rrugë të tjera nga ato të pasqyruara në pyetësor. Asnjë i anketuar nuk referon të jetë ankuar në institucione të tjera që kanë për detyrë monitorimin. Një pjesë e vogël e tyre kanë përgatitur kërkesë dhe rekomandime për ndryshim, ndërsa një pjesë akoma më e vogël kanë mbledhur firma të qytetarëve dhe të grupeve të interesit në iniciativave dhe ndonjë peticion, për ndonjë çështje të caktuar.



Grafiku 18 : Rrugët e ndjekura kur nuk bihet dakord me projektaktin

Në lidhje me pyetjen "*Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik me qytetarët dhe grupet e interesit që ju përfaqësoni?*", përgjigjet e të anketuarve përfshijnë: mungesën e ndërjegjësimin, shpesh mosaksesueshmërinë e informacionit, kohën dhe burimet e kufizuara, mungesën e besimit, pjesëmarrjen selektive, konsultimet joefektive, mungesën e kapaciteteve, problemet ligjore dhe rregullatore, informacionin që shpesh vjen nga rrjetet sociale ose OJF-të, mos përdorimin e rrjeteve sociale nga të gjithë, besimin, mos informimin e duhur dhe në kohë, diskriminimin dhe stigmatizimin, transparencën, nevojën për përdorimin e formave të



ndryshme të informimit për Konsultim Publik ku mesazhet në telefon apo *e-mail* janë më direkte dhe efikase për të zgjuar interes për informimin e mëtejshëm për konsultimin publik, mungesën e interesit nga qytetarët dhe mos njoftimin në kohë.

Pjesa më e madhe e të anketuarve (53.3%) pranojnë se është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të Proceseve të Informimit dhe Konsultimit. Shumica e pjesës së mbetur (30%) pohon se është rritur disi, ndërsa një pjesë shumë e vogël (16.7%) beson se është ende në nivele të ulëta. Ata që besojnë se është rritur aktivizimi i qytetarëve, mendojnë se ky aktivizim është rritur duke marrë parasysh apo duke dhënë sugjerime, duke rritur pjesëmarrjen qytetare, falë mbështetjes së disa organizatave që ndihmojnë qytetarët, si dhe për shkak se qytetarët sot janë më aktivë dhe më të ndërgjegjësuar për pjesëmarrje në aktivitete të Bashkisë që kanë ndikim në komunitet apo që lidhen direkt me interesin e tyre. Ky aktivizim është arritur edhe duke koordinuar përpjekjet me të gjitha palët e interesuara, përfshirë institucionet publike, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, për të krijuar një proces gjithëpërfshirës, transparent dhe efektiv. Një pjesë e vogël mendon se ka ende një mungesë besimi tek grupet e interesit në Procesin e Konsultimit Publik dhe tek institucionet që e realizojnë atë.

Referuar rezultateve të përshkruara më sipër, një nga gjetjet më të rëndësishme të pyetësorit është se shumica e qytetarëve (74.04%) nuk kanë marrë pjesë në dëgjesat publike të organizuara nga Bashkia apo Këshilli Bashkiak gjatë dy viteve të fundit. Rezultati është më i mirë tek intervistat me grupet e interesit, por gjithsesi mbetet i pakënaqshëm, pasi 53% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë marrë pjesë në dëgjesat publike.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se grupet e interesit dhe qytetarët kanë perceptime dhe përvoja të ndryshme lidhur me procesin e Konsultimit Publik. Gjithsesi të dy grupet evidentojnë nevojën për përmirësime në informimin, transparencën dhe përfshirjen në proceset vendimmarrëse. Diferencat në perceptime dhe përvoja vijnë nga nivele të ndryshme informimi, burime informacioni, angazhim dhe besim në proces, si dhe sfida specifike që hasin secili grup. Kjo sugjeron nevojën për strategji të ndryshme për të rritur informimin, përfshirjen dhe besimin në proceset e konsultimit publik për të dy grupet.

- Organizatat joqeveritare, bizneset dhe aktivistët e shoqërisë civile kanë një ndërgjegjësim më të lartë për proceset dhe të drejtat e Konsultimit Publik për shkak të përfshirjes së tyre të drejtpërdrejtë në çështje komunitare dhe qeverisje. Ata shpesh marrin pjesë në trajnime dhe seminare dhe kanë qasje në burime të specializuara të informacionit. Në krahasim, qytetarët e zakonshëm mund të mos kenë të njëjtin nivel ndërgjegjësimi dhe informimi për Proceset e Konsultimit Publik, duke qenë më pak të ekspozuar ndaj burimeve të informacionit dhe mundësive edukative.
- Grupet e interesit marrin pjesë rregullisht në Proceset e Konsultimit Publik, japin rekomandime dhe ndjekin zhvillimet e politikave lokale, duke fituar kështu një perspektivë më të qartë dhe të thelluar mbi sfidat dhe mundësitë e këtyre proceseve. Në anën tjetër, qytetarët mund të kenë pak ose aspak përvojë në

konsultimet publike. Mungesa e pjesëmarrjes së rregullt dhe përvojës praktike çon në perceptime të ndryshme dhe më të paqarta për efektivitetin e këtyre proceseve.

- Rezultatet tregojnë se grupet e interesit dhe qytetarët kanë perceptime dhe përvoja të ndryshme lidhur me Procesin e Konsultimit Publik. Të dy grupet evidentojnë nevojën për përmirësime në informimin, transparencën dhe përfshirjen në proceset vendimmarrëse. Diferencat në perceptime dhe përvoja vijnë nga nivele të ndryshme informimi, burime informacioni, angazhim dhe besim në proces, si dhe sfida specifike që hasin secili grup. Kjo sugjeron nevojën për strategji të ndryshme për të rritur informimin, përfshirjen dhe besimin në Proceset e Konsultimit Publik për të dy grupet.
- Grupet e interesit marrin pjesë më shumë në Proceset e Konsultimit Publik, ka raste që japin rekomandime dhe ndjekin zhvillimet e politikave lokale, duke fituar kështu një perspektivë më të qartë dhe të thelluar mbi sfidat dhe mundësitë e këtyre proceseve. Në anën tjetër, qytetarët mund të kenë pak ose aspak përvojë në konsultimet publike. Mungesa e pjesëmarrjes së rregullt dhe përvojës praktike çon në perceptime të ndryshme dhe më të paqarta për efektivitetin e këtyre proceseve.

Kjo analizë e pyetësorit tregon se, në përgjithësi, Procesi i Konsultimit Publik në Korçë ka ka ndryshim, por ka ende shumë hapësira për përmirësime, sidomos në transparencë, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në nivel të barabartë. Rritja e besimit dhe përdorimi i kanaleve të diversifikuara për njoftimin dhe konsultimin mund të kontribuojë në një proces më efektiv dhe më të përfshirë për të gjitha palët e interesuara.

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### Konkluzione

Nga analizimi i procesit të konsultimit publik dhe transparencës në Bashkinë Korçë, janë identifikuar disa gjetje dhe mundësi për përmirësim:

- Aktualisht, nuk ekziston një pozicion i dedikuar ekskluzivisht për koordinimin e procesit të konsultimit publik, çka ndikon negativisht në menaxhimin e tij dhe në përputhshmërinë me kërkesat ligjore.
- Bashkia Korçë ka krijuar një Rregjistër Elektronik të Projektakteve për Konsultim Publik, i cili centralizon dhe strukturon projektaktet dhe dokumentet në proces konsultimi. Ky sistem ofron akses për qytetarët për të ndjekur dhe kontribuar në proceset e konsultimit.
- Aktualisht nuk është e mjaftueshme transparenca në publikimin e planeve vjetore të vendimmarrjes, të cilat nuk janë të aksesueshme për qytetarët siç kërkohet nga ligji nr. 119/2014. Kjo bën që qytetarët të mos kenë qasje të plotë në informacionet e nevojshme për përfshirje në proceset vendimmarrëse.

- Edhe pse Bashkia Korçë ka një formë të standardizuar për njoftimet publike, ajo nuk përdoret gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme. Njoftimet shpesh bëhen në kategorinë "Njoftime" dhe rrallë në Programin e Transparencës, duke munguar elemente të rëndësishme si data e publikimit dhe adresa e email-it për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve. Kjo çon në paqartësi dhe mungesë informacioni për qytetarët, duke ulur transparencën dhe pjesëmarrjen efektive në proceset e konsultimit publik.
- Mungesa e një regjistri të qartë dhe të përditësuar për pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultimet publike, së bashku me format e pamjaftueshme të komunikimit, pengon angazhimin e plotë dhe përfshirjen e gjerë të komunitetit në proceset vendimmarrëse. Ky deficit krijon një hendek në transparencë dhe përgjegjshmëri, duke ndikuar negativisht në besimin dhe efektivitetin e politikave publike.
- Programi i Transparencës në Bashkinë Korçë nuk është në përputhje të plotë me detyrimet dhe kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 119/2014 dhe shkresën nr. 3570 (mars 2024) të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo sjell pasiguri ligjore, ul besimin e publikut në institucionet lokale dhe mund të kufizojë aksesin e qytetarëve në informacionin publik.
- Projektvendimet shpesh nuk përfshijnë përmbledhje të rekomandimeve të pranuar dhe të papranuara, çka ndikon negativisht në transparencën dhe besueshmërinë e procesit të konsultimit publik.
- Kanale dhe metoda të reja komunikimi mungojnë, duke bërë që përfshirja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse të mbetet e ulët dhe joefektive.
- Informimi i pamjaftueshëm i qytetarëve, veçanërisht i të rinjve, rreth Ligjit për Konsultimin Publik ka rezultuar në një pjesëmarrje të ulët në proceset konsultative. Megjithatë, përpjekjet e Bashkisë, përmes publikimit të një videoje informuese dhe organizimit të një sesi informues në qershor 2024, tregojnë një angazhim të rëndësishëm për të përmirësuar këtë situatë. Këto iniciativa kanë për qëllim të rrisin ndërgjegjësimin dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e komunitetit, duke nënvizuar rëndësinë e kontributit të qytetarëve në vendimmarrje dhe ndryshime të rëndësishme në nivel lokal.
- Në përfundim, mungesa e anketimeve dhe metodave të tjera për të matur nivelin e kënaqësisë dhe besimit të qytetarëve në proceset e konsultimit publik pengon vlerësimin e saktë të efektivitetit të këtyre proceseve. Pa këtë informacion të rëndësishëm, është e pamundur të identifikohen problemet dhe nevojat e qytetarëve, gjë që kufizon ndjeshëm mundësitë për përmirësimin e proceseve konsultative dhe për rritjen e angazhimit qytetar.
- Mungesa e një sistemi të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi për proceset e njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Korçë krijon një boshllëk të rëndësishëm në përshkrimin dhe kuptimin e gjendjes aktuale të këtyre proceseve. Kjo mungesë e strukturës monitoruese e bën të vështirë identifikimin e dobësive dhe sfidave, duke penguar kështu zbatimin e masave për përmirësim. Për më tepër,

pa monitorim dhe vlerësim të rregullt, është e pamundur të vlerësohet me saktësi efektiviteti i njoftimeve dhe konsultimeve. Implementimi i një sistemi të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi do të siguronte një pasqyrë më të qartë mbi performancën e këtyre proceseve dhe do të ndihmonte në përmirësimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme.

## **Rekomandime**

- Rekomandohet krijimi i një pozicioni të veçantë për Koordinatorin e Konsultimit Publik në Bashkinë Korçë. Kjo masë do të sigurojë një menaxhim më të mirë dhe përputhje me kërkesat ligjore, duke kontribuar në një Proces Konsultimi Publik më të strukturuar, transparent dhe efektiv.
- Për të përmirësuar transparencën dhe përputhshmërinë me ligjin nr. 119/2014, rekomandohet publikimi i të gjitha planeve vjetore të vendimmarrjes në programin e transparencës. Këto plane duhet të jenë të aksesueshme për qytetarët dhe të përmbajnë të gjitha nismat përkatëse për vitin e ardhshëm, duke rritur përfshirjen e publikut dhe përmbushur detyrimet ligjore.
- Rekomandohet krijimi dhe zbatimi i një formati standard për Njoftimet e Konsultimeve Publike, që përfshin të gjitha informacionet e nevojshme për qytetarët. Kjo do të rrisë transparencën dhe efektivitetin e Procesit të Konsultimit Publik.
- Krijimi i një regjistri të qartë dhe të përditësuar për pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet dhe konsultimet publike dhe të përdoren forma të reja komunikimi më efektive.
- Rekomandohet që Bashkia Korçë të nisë procedurat për rishikimin dhe miratimin e Programit të Transparencës, duke siguruar përfshirjen e të gjitha detyrimeve dhe kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr. 119/2014 dhe shkresën nr. 3570, datë 6.03.2024, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Të sigurohet që çdo projektvendim të shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar dhe një përshkrim për arsye të qarta në lidhje me rekomandimet që nuk janë pranuar. Ky informacion është i domosdoshëm për të përmbushur dispozitat e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe për të rritur transparencën dhe besueshmërinë në procesin e konsultimit publik.
- Zhvillimi i kanaleve dhe metodave të reja komunikimi për të rritur përfshirjen e qytetarëve dhe sigurimi që Proceset e Konsultimit Publik të jenë jo vetëm transparente, por edhe ndikueshme në vendimmarrje.

- Për të adresuar mungesën e njohurive mbi Ligjin për Konsultimin Publik, rekomandohet që Bashkia dhe Këshilli Bashkiak të organizojnë fushata informuese dhe edukative për qytetarët, sidomos me të rinjtë. Gjithashtu, vendosja e ndërlidhësve komunitarë mund të ndihmojë në informimin dhe mbështetjen e qytetarëve për të kuptuar dhe zbatuar ligjin.
- Zhvillimi dhe aplikimi i anketimeve ose metodave të tjera për të matur nivelin e kënaqësisë dhe besimit të qytetarëve në Proceset e Konsultimit Publik, duke siguruar përmirësim të qëndrueshëm të transparencës dhe efektivitetit.
- Implementimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi të brendshëm të Procesit të Njoftimit dhe konsultimit publik për të siguruar transparencë dhe pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve. Kjo do të ofrojë një përshkrim më të qartë dhe të plotë të gjendjes së Procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Korçë.

## REFERENCA

Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik:

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

Faqe web POP: <https://popnetwork.al/>

RAPORTI STUDIMOR “INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK” – BASHKIA KORÇË

<https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-korce/>

Neni 16 dhe neni 18, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/12/17/139>

RREGULLORE E DETAJUAR PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E ADMINISTRATËS SË BASHKISË KORÇË:

<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/RREGULLORE.pdf>

Urdhër për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2024:

[https://drive.google.com/file/d/1ZluLJ\\_ZEvLFtdEnaihDCZ3aR9LbrC35M/view](https://drive.google.com/file/d/1ZluLJ_ZEvLFtdEnaihDCZ3aR9LbrC35M/view)

Lista e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Korçë 2023-2027:

[https://drive.google.com/file/d/1wGsn0opkfa4\\_iZsbiDJpaSSczCgxN47k/view](https://drive.google.com/file/d/1wGsn0opkfa4_iZsbiDJpaSSczCgxN47k/view)

Vendim për ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak  
Korçë: <https://drive.google.com/file/d/1uodTMFPEBsiihjN4tb0M4rxkEMVOC3wu/view>

Regullore të Këshillit Bashkiak Korçë:  
<https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=316&t=Rregulloret-e-K%C3%ABshillit-Bashkiak>

Regullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Korçë  
<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Rregullore%20Bashkia%20Kor%C3%A7%C3%AB.%20Dokumenti%20final%20Dt.04.08.2020.pdf>

RREGULLORE E KËSHILLIT BASHKIAK MARRËDHËNIET E KËSHILLIT BASHKIAK ME  
PUBLIKUN DHE MEDIAN  
<https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/MARR%C3%8BDH%C3%8BNIET%20E%20K%C3%8BSHILLIT%20BASHKIAK%20ME%20PUBLIKUN%20DHE%20MEDIAN%20%282%29.pdf>

